


LAJMETARI

I BERATIT



Adresa: L. "30 Vjetori", tek stadiumi i vjetër
Tel & Fax ++ 355 32 36 932
Cel: 069 20 97 685

Viti III, Nr. 49 (124) E përjavshme e pavarur

E hënë, 23 janar 2006

Çmimi 20 lekë (1 Euro)

Adresa: Lagjia "Dëshmorët e Kombit", pranë shtypshkronjës "Lirisan Ekspres".

Tel: + 069 2247353

Adresa në internet: www.lajmetari.net

e-mail: redaksia@lajmetari.net

KRONIKË

Berati në portat e UNESKO-s

Faqe 2

INTERVIST

Kryetari i qarkut Pelivan Shatri flet për investimet në 2006-ën

Faqe 3

DEBAT

Bujar Orizaj Letër drejtorit të KESH-it

Faqe 6

OPINION

Ervin Hatibi Që feja t'i kthehet vërtet Zotit

Faqe 8

EDITORIAL

Rugova: Udhëheqësi i lëvizjes për pavarësi

Nga Ilir Ikononi


Dr. Ibrahim Rugova do të kujtohet si njeriu që iu përkushtua arritjes së pavarësisë së Kosovës me mjete paqësore. Në një farë mënyre, vdekja e tij i ngjan humbjes së një profeti: ai parashikoi me kohë një protektorat ndërkombëtar për Kosovën si hapi i parë drejt pavarësisë. Gjatë vitit 2005, Kosova hyri në një fazë të rëndësishme për përcaktimin e statusit të saj përfundimtar dhe ideja e Dr. Rugovës që ky status të jetë pavarësia ndodhet tani para një sfide.

17 vjet më parë, më 1988, kur u zgjodh në krye të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, Dr. Rugova filloi të identifikojë gjithnjë e më shumë me opozitën e hapur ndaj sundimit komunist jugosllav në Kosovë. Ai u bë intelektual që fliste hapur në kërkim të të drejtave për shumicën shqiptare dhe në dhjetor 1989, u zgjodh kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e cila ndonëse një lëvizje me karakter të gjerë, ishte në fakt grupimi i parë politik i këtij lloji në Kosovë.

Si kryetar i Lidhjes Demokratike, Rugovës dhe bashkëpunorëve të tij iu desh të punonin në kushtet kur udhëheqësi serb Slobodan Millosheviç kishte filluar tashmë të vepronte me dorë të hekurit në Kosovë, duke i hequr asaj autonominë. Rugova u përgjigj me rezistencë paqësore, të cilën e vazhdoi për një dekadë. Ai u bërë nismëtar i një sistemi që ekzistonte paralelisht me qeverisjen serbe në Kosovë.

Gjatë viteve 90, Rugova gëzonte mbështetje të gjerë të brendshme dhe të jashtme për politikën e tij paqësore. Në vitin 1996, kur me nismën e Shteteve të Bashkuara, në Dayton të Ohios palët ndërluftuese ballkanike u ulën në tryezën e bisedimeve, Dr. Rugova nuk arriti të bindte komunitetin ndërkombëtar që në konferencë të shtrohej edhe zgjidhja e çështjes së Kosovës. Moszgjidhja e statusit të Kosovës e shtoi padurimin mes shqiptarëve dhe shqetësimin e tyre se ata mund të lireshin pafundësisht nën sundimin e Beogradit. Në skenë doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Rritja e UÇK-së e pakësoi mbështetjen për politikën paqësore të Dr. Rugovës. Mbi qiejllin e Kosovës retë po errësoheshin dhe Shtetet e Bashkuara së bashku me evropianët shikonin afrimin e stuhisë. Diplomacia ndërkombëtare u vu në lëvizje për të parandaluar një masakër si ajo e Bosnjes.

Vijon në faqen 4



Ikona e qëndrësës paqësore të shqiptarëve në Ballkan, Ibrahim Rugova

Anastas Pjetri

Klientobuxhetorët dhe RAIFFEISENBANK

Faqe 10

Kujtim Kashari

Përbuzja si kompleks inferioriteti

Faqe 10

Kronika e Beratit

nga Abedin Kaja

Faqe 7

Një ligj kundër ligjit

Faqe 5

Rrëfenja

nga Agim Mehqemeja,
Namik Selmani.

Faqe 14

Faqja sportive nga Vlash Pambuku

Faqe 15-16

Shtëpia e Bojërave


Bojëra, plastiko,
hidromat, pigmente etj...

Tel: 37 290.

Pranë postës elektronike [micro.it](mailto:info@micro.it)

Si mund të mbroni automjetet tuaja?

TEXACO



Goma të ndryshme

ALDOM

Pjesë këmbimi me porosi për auto


Përdorni vajra të cilësisë së lartë

KËTU DO TË GJENI me shumicë dhe pakicë:

Shell



FILTRA



ëndra (eskavator, fadrom,

Adresa:

arku i Urës Vajgu
allë Western Unic

inistrator: Edison
el: 0682235888; (

eshi
22

Berati në portat e UNESCO-s

Gati dosja e pranimit

Lajmin e bënë të ditur grupi i specialistëve të tri dikastereve që punuan për rreth 8 muaj për përgatitjen e kësaj dosjeje.

Në bazë të të gjitha kërkesave standarte dhe me veçantitë e duhura që kërkon UNESCO për t'u bindur për vlerat e një trashëgimie kulturore që të përfshihet nën kujdesin e saj, specialistët e Ministrisë së Kulturës, të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe ata të bashkisë së Beratit kopsitën materialet e duhura për t'u paraqitur në komisionin për miratim të UNESCO-s brenda këtij gjatëgjatësi të parë të këtij viti në atë institucion.

Grupi i specialistëve është mbledhur në një takim të posaçëm në bashkinë e Beratit për të prezantuar përfundimin e plotësimit të dosjes dhe për të kontrolluar kërkesat e palës pritëse, e cila do të shqyrtojë në një komision të posaçëm mundësinë e pranimit të qytetit të një mbi një dritareve në UNESCO.

Në takimin, i cili u bë me interesimin e posaçëm të kryetarit të bashkisë së Beratit, z. Fadil Nasufi, ishin të pranishëm edhe Azedin Beshasha, këshilltar i parë i Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s dhe Muhamet Bej Mamin, Drejtor i Përgjithshëm i institutit të Kulturës së Tunizisë si të dërguar të posaçëm nga UNESCO për këtë qëllim.




foto Miltjadh Bibo

Lista e objekteve të veçanta të shpallur monument kulture në Berat

1. Kalaja e qytetit, 1978.
2. Kalaja në lagjen "Goricë", 1977.
3. Ura mbi lumin Osum, që lidh Goricën me Beratin, 1948.
4. Rrënojat e Kullës së Sahatit, në Çelepias, 1984.
5. Kisha e Shën Mëhillit, lagjja Mangalem, 1984.
6. Kisha e Shën Triadhës, lagjja Kala, 1984.
7. Kisha e Shën Marisë Vlahernës, lagjja Kala, 1948.
8. Kisha e Shën Todri, lagjja Kala, 1961.
9. Katedralja Fjetja e Shën Marisë, lagjja Kala, 1948.
10. Xhamia Mbret, lagjja "28 Nëntori", 1948.
11. Rrenoja e Xhamisë së Kuqe, lagjja Kala, 1961.
12. Rrenoja e Xhamisë së Bardhë, lagjja Kala, 1962.
13. Xhamia e Beqarëve, lagjja Mangalem, 1961.
14. Xhamia Plumbit, lagjja "10 Korriku", 1961.
15. Teqeja e Xhelvetive, lagjja "28 Nëntori", 1961.
16. Sarajet e Vrionasve, lagjja Mangalem, 1961.
17. Kinema "22 Tetori", lagjja "22 Tetori", 1961.
18. Banesa e Todi dhe Kostaq Xhokaxhiut, lagjja Mangalem, 1961.
19. Banesa e Lllazar Haxhistasës, lagjja Kala, 1961.
20. Banesa e Mak Haxhistasës, lagjja Kala, 1961.
21. Banesa e Cac Dollanit, lagjja Kala, 1961.
22. Banesa e Naum Dushnikut, lagjja Kala, 1961.
23. Banesa e Haxhi Mehmetit, lagjja Kala, 1961.
24. Banesa e Tak Kiqos, lagjja Mangalem, 1961.
25. Banesa e Anastas Xhymyrtkës, lagjja Mangalem, 1961.
26. Banesa e Mihal Bërdunit, lagjja Mangalem, 1961.
27. Banesa e Ansatas Guxhumanit, lagjja Mangalem, 1961.
28. Banesa e Gaqi Gjergos, lagjja Mangalem, 1961.
29. Banesa e Llamba Aguridhit, lagjja Mangalem, 1961.
30. Banesa e Lambi Kolovanit, lagjja Mangalem, 1961.
31. Banesa e Lili Vrohoritit, lagjja Mangalem, 1977.
32. Banesa e Sotir Doracit, lagjja Mangalem, 1961.
33. Porta e shtëpisë së Vrionasve, lagjja Mangalem, 1963.
34. Ish-selamlëku i Vrionasve, lagjja Mangalem, 1961.
35. Banesa e Lip Pulit, lagjja Goricë, 1961.
36. Banesa e Nikollaq Haxhos, lagjja Goricë, 1961.
37. Banesa e Taq Simsisë, lagjja Goricë, 1961.
38. Banesa e Luçi Dollanit, lagjja Goricë, 1961.
39. Banesa e Irakli Xhimitikut, lagjja Goricë, 1961.
40. Banesa e Luç Zaharisë, lagjja Goricë, 1961.
41. Banesa e Lefter Kolovanit, lagjja Goricë, 1961.
42. Banesa e Gaqo Samarxhiut, lagjja Goricë, 1961.
43. Banesa e Nasi Pushit, lagjja Goricë, 1961.
44. Banesa e Bozho Filerit, lagjja Goricë, 1961.
45. Banesa e Vangjel Xhekës, lagjja Mangalem, 1961.
46. Banesa e Gjergos, lagjja Mangalem, 1961.
47. Banesa e Vlasi Xheblatit, lagjja "13 shtatori", 1961.
48. Banesa shtetërore, lagjja Mangalem, 1983.
49. Banesa e Syrja Haznedarit, lagjja "1 Maj", 1961.
50. Banesa e Dudë Mishaxhiut, lagjja "1 Maj", 1961.
51. Banesa e Sheh Hasanit, lagjja "28 Nëntori", 1961.
52. Banesa e Rexhep Llapit, lagjja "28 Nëntori", 1961.
53. Banesa e Toli Pinës, lagjja "28 Nëntori", 1961.
54. Banesa e Vajde Myftiut, lagjja "28 Nëntori", 1961.
55. Banesa e Skënder Kamenikut, lagjja "D. e Kombit", 1961.
56. Banesa e Aishe Kamenikut, lagjja "D. e Kombit", 1961.
57. Banesa e Ali Kukunjës, lagjja "Dëshmorët e Kombit", 1961.
58. Banesa e Bule Mukavelatit, lagjja "Çlirim", 1961.
59. Banesa e Qamil Nartës, lagjja "Çlirim", 1961.
60. Banesa e Neki Novës, lagjja "Muzaka", 1961.
61. Banesa e Stavro Manestrës, lagjja Goricë, 1961.
62. Banesa e Llukë Bullarit, lagjja Goricë, 1961.
63. Banesa e Vrionasve (1 dosje), lagjja Mangalem, 1978.
64. Konakët e Teqes së Xhelvetive, lagjja "28 Nëntori", 1963.

Lajmëtar

Qyteti i Beratit i shpallur "Qytet-muze" në vitin 1961, përveç vlerave të veçanta kulturore dhe arkitekturore që mbart për nga historia e lashtë dhe trashëgimia mbi 24-shekullore, ka tri lagje brenda tij të shpallura lagje-muze, të cilat janë lagjet Kala, Mangalem dhe Goricë.

Gjithashtu në qytetin e Beratit si në lagjet-muze ashtu edhe në lagje të tjera janë objekte me vlera të veçanta kulturore dhe të shpallur "monument kulture" me vendim Qeverie, 64 objekte. Nga këto objekte mund të përmenden 2 ura, 7 kisha e katedrale, 6 xhami e teqe, 52 shtëpi e banesa të veçanta, etj. Nëse Berati pranohet të futet në listën e vlerave të trashëgimisë botërore që ka UNESCO, është i tretë pas Butrintit dhe Gjirokastrës nga Shqipëria.

Qyteti-muze

Me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, më 1961 është shpallur qytet-muze Berati dhe Gjirokastra. Pas këtij vendimi në Berat është ngritur dega e Monumenteve të Kulturës në varësi të Institutit të Monumenteve të Kulturës, e cila, mbi bazën e studimeve dhe projekteve të hartuara nga specialistët, zbaton punimet e restaurimit si dhe mbron monumentet e kulturës nga dëmtimet si dhe nuk lejon ndërtime të pastuduara në shtëpitë apo lagjet-muze.

Qarku ka vetëm një qytet-muze, Beratin, dhe 108 objekte të shpallur monument kulture me vlera.

Çfarë përfitimesh ka përfshirja në listën e UNESCO-s

Përfitimi është në radhë të parë moral e jo shumë material. Pra duhet kuptuar se UNESCO nuk jep fonde për qendrat e përfshira në listën e saj. UNESCO është një garanci për vlerat që mbart vendi apo qyteti i përfshirë në listën e saj. Ajo

promovon vlerat për turistët të cilët vënë në axhentën e tyre vizita të posaçme me përparësi në vendet e listuara nga UNESCO.

Gjithashtu UNESCO është një garanci për donatorët që investojnë për reabilitimin dhe mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës, të cilët kanë përparësi në ato vlera që ka promovuar UNESCO. Kjo organizatë jep asistencë dhe këshilla me specialistë për restaurimet, ruajtjen dhe reklamimet që u bëhen vlerave monumentale të përfshira në listën e trashëgimisë botërore.

Kriteret që u ndoqën për dosjen

Specialistët e Ministrisë së Kulturës kanë punuar për të plotësuar dosjen sipas standarteve të vëna që më parë nga UNESCO. Duke pasur parasysh dosjet analoge të objekteve të tjera, përvojën dhe punën për dosjet e Butrintit dhe të Gjirokastrës, ata si përfaqësues të qeverisë shqiptare punuan në linjat kryesore të dokumentacionit për dosjen e Beratit.

Specialistët e Institutit të Monumenteve të Kulturës kanë plotësuar dosjen me vlerat që ka Berati dhe arsyt pse këto vlera të trashëguara e të ruajtura duhen përfshirë në listën e trashëgimisë botërore.

Specialistët e Bashkisë së Beratit, të ndihmuar nga ata italianë, kanë përgatitur pjesën e menaxhimit të vlerave kulturore e trashëgimisë së Beratit nën kujdesin e UNESCO-s. Mënyra e promovimit të këtyre vlerave, kushtet për turizmin ditore e familjar si dhe kushtet e strehimit e të ardhurat që do të sjellë turizmi në këtë qytet të përfshirë në listën e trashëgimisë botërore.

Të gjitha këto së bashku përbëjnë materialin voluminoz që ka dosja e cila pret të paraqitet para komisionit të pranimit të UNESCO-s së shpejti. Pavarsisht nga vlerat që ka e mbart një qytet-muze si Berati, është e rëndësishme mënyra e paraqitjes së tyre dhe bindja që duhet bërë për komisionin që të pranohet në UNESCO.

Polka , kjo është rruga nëpër të cilën kalojnë investimet tona

(Transparenca në kryerjen e investimeve, kyçi i sukseseve tona)

Planifikim, organizim dhe kontroll gjatë gjithë procesit të kryerjes së investimit, kjo është rruga nëpër të cilën kalon një investim i dhënë nga këshilli i qarkut Berat. Kush merr përsipër të kryejë një investim të dhënë nga ky institucion, duhet që ta pyesë veten mirë, asgjë nuk mund të tolerohet, gjithçka bëhet transparente në menyrë të vazhdueshme dhe në sy të publikut. Në një intervistë të dhënë nga kryetari i këshillit të qarkut, z.Pelivan Shatri, është rrëfyer për arritjet në vitin 2005 dhe objektivat që ka këshilli i qarkut për vitin 2006.

Cilat janë burimet financiare më të cilat ju kryeni investime në qarkun e Beratit?

Në zbatim të politikës së shtetit shqiptar për decentralizimin e investimeve, me vendim të Këshillit të Ministrave të muajit shtator 2004, Nr. 636, në qarkun e Beratit na erdhën fonde nga Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, si dhe nga granti dhe të ardhurat që siguron vetë këshilli i qarkut. Pra, burimet e financimit kanë qenë këto katër ministri për shkollat, për qendrat shëndetësore dhe për rregullimin e territorit.

Cila është puna më e dukshme dhe e prekshme që keni realizuar për vitin 2005 ?

Investimet më kryesore për vitin 2005 kanë qenë ato për rikonstruksionin e shkollave, të cilat kanë qenë të shkatërruara dhe të rrënuara, që kërkonin ndërhyrje urgjente. Kështu, kemi kryer investime në shkollën e komunës Poshnje, në shkollën Veterrik të komunës Starovë, Starovë qendër, në disa shkolla të Skraparit, në tri shkolla të Kuçovës, si dhe në tri shkolla të zonës së Lapardhasë, komuna Otlak. Ne përveç ndërhyrjeve me fondet e Ministrisë së Arsimit, kemi ndërhyrë edhe me fondet e këshillit të qarkut. Po kështu, ne kemi ndërtuar në disa qendra shëndetësore, si ambulanca në zonat e thella dhe të largëta, siç janë ato të Zhëpës dhe Backës në rrethin e Skraparit. Në secilën nga komunat ne ndërtuam nga një qendër shëndetësore për t'i ardhur në ndihmë komunitetit të këtyre zonave që, për shkak të largësisë, e kanë të pamundur të komunikojmë me qytetin në rastet e urgjencave shëndetësore për marrjen e ndihmës së parë. Gjithashtu kemi blerë dhe disa pajisje shkollash, si karrige, tavolina, dërrasa të zeza, etj., të cilat i kemi shpërndarë në bazë të një plani të përbashkët me DRA-in Berat. Gjithmonë kemi kërkuar që këto investime të bëheshin sa më cilësore. Për realizimin e këtyre investimeve, kemi ndjekur një segment të caktuar, d.m.th. fotografuam objektin siç është në gjendjen e mëparshme, më pas e fotografuam punën që kemi realizuar duke ndjekur anën cilësore në vazhdimësi, për të mbyllur kështu çdo shteg të abuzimeve në këtë drejtim.

Cilat janë disa nga investimet më të rëndësishme në vlerë leku që keni realizuar në qarkun e Beratit për vitin që sapo lamë pas?

Disa nga investimet më të rëndësishme të vitit që sapo lamë pas në vlerë leku janë ato të realizuara në arsimin parauniversitar me një vlerë prej 54.371 mijë, në shëndetësi janë realizuar 30.470 mijë lekë. Nga Ministria e Rregullimit të territorit dhe Turizmit është ndërhyrë në pesë objekte me 26.770 mijë lekë. Nga të ardhurat e qarkut ne kemi vepruar në dy mënyra, me ndërhyrje direkte siç kemi ndërhyrë në rrugë, në shkolla apo me delegim në njësitë e pushtetit vendor në dy ndërmarrjet e rrugëve në Berat dhe Skrapar, ndërmarrje të cilat janë në vartësi të këshillit të qarkut. Pas një sërë propozimesh dhe diskutimesh, në fund është konkluduar dhe duke u detajuar saktësisht në bashkëpunim edhe me komunat dhe njësitë e tjera vendore, këto detajime u prokuruan sipas


objekteve në zbatim të ligjit të qeverisë, Nr. 7971, dt.26.07.1995, si dhe ndryshimeve që ka patur në zbatim të këtij ligji me aktet ligjore dhe nënligjore të tij.

Sa transparente kanë qenë keto investime ?

Ne kemi ndjekur me fanatizëm realizimin e këtyre investimeve duke i bërë ato sa më transparente për komunitetin. Dhe kjo jo vetëm nëpërmjet dokumentave, por ato janë dhe të dukshme dhe të prekshme si nga ana sasore ashtu edhe nga ana cilësore .Që kur ka filluar të realizohet për herë të parë në vend decentralizimi i investimeve dhe duke i kaluar qarkut një pjesë e tyre nga qeveria shqiptare, e cila i trajtonte me parë, ne në plan të parë kemi patur bërjen sa më transparente të investimeve për publikun dhe i kemi vënë si qëllim vetes që të nderohemi për punën e kryer dhe jemi munduar që gabimet në drejtim të punës sonë të jenë sa më të vogla. Për këtë kemi zbatuar dy parime. Parimi i parë, ne të gjithë së bashku kërcejmë Polkën, që do të thotë: P-Planifikim, O-Organizim, L-Lider që udhëheq punën dhe këtë e bëjmë të gjithë së bashku, K-Kontroll në maksimum dhe në vazhdimësi për punën e kryerë dhe A-Axhustim që do të thotë, në qoftë se puna ka defekte, si p.sh kur pikon një shkollë pas investimit, ne i kërkojmë firmes që ka kryer këtë punë ta fillojë edhe njëherë nga e para atë. Shembull konkret kemi një firmë të cilën unë dua ta falënderoj . Ishte një mur në zonën e Duhanasit, komua Velabisht, i ndërtuar nga kjo firmë që për shkak të shirave të dendura që ranë para një muaji në qarkun e Beratit ky mur u shemb. Edhe pse muri i shembur nuk ishte për faj të punës pa cilësi nga ana e firmës ndërtuese, kjo firmë e ndërtoi murin nga e para me lekët e saj. Kjo do të thotë se kush merr përsipër të kryejë investime të dhëna nga këshilli i qarkut duhet që ta pyesë veten mirë, pasi cilësia për punën e kryer për ne është një nga kërkesat kryesore dhe të patolerueshme. Pra, në këtë valë polkë e kemi bazuar në qendër në kontrollin e investimeve, që do të thotë se ne ato i kontrollojmë nga fillimi, gjatë procesit si dhe pas përfundimit të këtij procesi.

Cilat janë objektivat për vitin 2006 dhe si do t'i realizoni ato?

Këshilli i qarkut është në pozicion pune dhe këto arritje janë të mbështetura në parametra bashkëkohor. Ne kemi një drejtori të urbanistikës, e cila sot është në gjendje që me profesionalizëm të lartë shkencor t'i përgjigjet çdo projekti në qarkun e Beratit, pavarësisht se ku shkon investimi në komunë, bashki apo qarkë. Ne jemi angazhuar që t'i shërbejmë këtij komuniteti. Kemi hartuar një projekt dhe e dimë se ç'duhet të bëjmë deri në vitin 2015. Projekti ynë për vitin 2006 është që të lidhet rruga midis Beratit dhe Skraparit. Ky investim do të vazhdojë dhe qeveria shqiptare do të akordojë një fond që ky aks rrugor të përfundojë. Ne i kërkojmë qeverisë që të akordojë një fond edhe për lidhjen e rrugës Berat-Elbasan në një distancë prej 30 km. Një investim tjetër që ne kërkojmë është edhe ai që qeveria shqiptare e ka një nga prioritetet e saj dhe që ne e mbështesim, korridori qendror-jugor Tiranë – Papër – Cerrik – Berat –Memaliaj. Investim tjetër që ne kërkojmë është që të vazhdohet rruga



e asfaltuar në drejtim të Përmetit nga zona e Terpanit. Do të ndërhyjmë në rrugët rurale jo vetëm për ti mirëmbajtur, por edhe për t'i përmirësuar ato në të gjithë qarkun e Beratit .Në drejtim të arsimit do të kemi një fond të veçantë dhe i kemi identifikuar shkollat që janë problem, të cilat do të rikonstrukturohen ose do të bëhen të reja, si në Qafë-Dardhë dhe Dardhë, shkolla e Mjeshovës, Kakrukës, Potomit, Tomorit, Fushë-Peshanit, etj. Ky projekt do të

bëhet konkret në një mbledhje të këshillit të qarkut, ku do të detajohen fondet për vitin 2006. Edhe në drejtim të shëndetësisë ne nuk do të qëndrojmë indiferent, por do të kryejmë investime në zonat që janë më të banueshme, me qëllim që aty të ketë një shërbim shëndetësor sa më afër komunitetit, sa më afër qytetarit. Presim që së shpejti të vijmë dhe të zbardhen zërat për vitin 2006 dhe ne, sapo të vijmë këto zëra, do t'i analizojmë ato në këshillin e qarkut dhe për këtë do të japim një konferencë për shtyp për të qenë sa më transparent me publikun, ashtu

NJOFTIM PER VENDIM TE LIRE PUNE

Ne zbatim te Ligjit Nr.8549, date 11.11.1999. "Statusi i nepunesit civil" , Drejtoria e Burimeve Njerezore ne Bashkine e Kuçoves , shpall konkurimin per nje vend te lire pune ne pozicionin:

Inxhinier ndertimi ne Drejtorine Ekonomike te Arsimit

Kandidatet duhet te plotesojne kerkesat e pergjithshme sipas nenit 12 te Ligjit 8549, date 11.11.1999, "Statusi i nepunesit Civil".

Kerkesat e vecanta per kandidatet jane :

1. Te kete mbaruar arsimin e larte ne nje nga deget e Fakultetit Ing. Ndertimi.
2. Te perdore lehtesisht programet baze te kompjuterit.
3. Te kete aftesi te mira menaxhuese dhe te punes ne grup.

Paga eshte 17.578 leke shtese pozicioni + 9306 paga e grupit + 2% per çdo vit jetetersi.

Dokumentat qe duhet te plotesojne kandidatet jane :

1. Kerkesen per aplikim
2. Curriculum vitae
3. Fotokopje e diplomes dhe listes se notave (e noterizuar).
4. Fotokopje e certifikatave te kualifikimit (e noterizuar).
5. Fotokopje e deshmise se kompjuterit (e noterizuar).
6. Vertetim i gjendjes gjyqesore
7. Fotokopje e librezes se punes (n.q.se do te kete) .
8. Mosparaqitje e plote e dokumentave sjell skualifikim te kandidatit .
9. Afati i dorezimit te dokumentave eshte deri ne daten 15.02.2006.

Konkurimi eshte i hapur per nepunesit civile te se njetes klase nepermjet procedurave te levizjes paralele , si dhe per kandidatet jashte administrates publike sipas procedurave te pranimit ne sherbimin civil .


Pas verifikimit paraprak , ne daten **20.02.2006**, ora **11.00** prane Bashkine Kuçove do te zhvillohet testimi me shkrim dhe me goje i kandidateve.

siç ishim edhe në realizimet e vitit 2005, me qëllim që gjërat të shikohen dhe të korrigjohen në duhur.

Bisedoi: A. Kaj

Rugova: Udhëheqësi i lëvizjes për pavarësi

Vijon nga faqja 1



Në fillim të vitit 1999, Dr. Rugova ishte ndër udhëheqësit shqiptarë që nënshkruan marrëveshjen e Rambujesë, e cila synonte zgjidhje paqësore të çështjes së Kosovës. Por dhuna e autoriteteve serbe në Kosovë u intensifikua dhe shpresat e komunitetit ndërkombëtar për një zgjidhje paqësore u shuan. Në mars të po atij viti, NATO-ja filloi bombardimet kundër Serbisë dhe Kosova u përfshi nga një valë spastrimi etnik. Dr. Rugova qendroi në Prishtinë, nën trysinë e jashtëzakonshme të forcave serbe të sigurimit. Në kulmin e bombardimeve, imazhi i tij politik thuajse u shkatërrua kur ai u shfaq përpara kamerave të televizionit duke u takuar me presidentin jugosllav Slobodan Millosheviç. Shumë analistë në atë kohë menduan se karriera e tij politike kishte marrë fund.

Por faktet treguan se popullariteti i Rugovës vazhdoi të ishte i madh. Në vitin 2002, ai u zgjodh president i Kosovës, ndërsa Lidhja Demokratike e udhëhequr prej tij ka fituar çdo zgjedhje që nga viti 1999. Largimi i forcave serbe nga Kosova në qershor 1999 çoi në vendosjen e një administrate të Kombeve të Bashkuara gjë që në fakt tregoi se profecia e Rugovës që Kosova të bëhej së pari një protektorat ndërkombëtar u realizua.

2005-a shënoi fillimin e procesit të shumëpritur për zgjidhjen e statusit të Kosovës duke u bërë viti kur premtimi i Dr. Rugovës për pavarësi dhe sovranitet filloi të vihej në provë të vërtetë. Dr. Rugova vazhdimisht ka përsëritur deklaratat e tij se pavarësia e Kosovës do ta qetësonte gjithë rajonin dhe do të ndihmonte zhvillimet demokratike në Ballkan.

Rugova i është përmbajtur pikëpamjes se pavarësia është kompromisi i vetëm i palës shqiptare pasi ajo nuk ka kërkuar bashkimin me Shqipërinë. Në muajin shtator, Presidenti Rugova njoftoi se ishte i siguruar se kanceler. Po atë muaj ai emëroi ekipin negociator në bisedimet për statusin, ekip që përfshinte edhe atë vetë. Por disa analistë janë shprehur se vdekja e Rugovës do të ndikojë negativisht në aftësinë e grupit negociator për të artikuluar platformën e tij në bisedime. Të tjerë kanë shprehur shqetësime se vdekja e tij mund të çonte në një luftë politike brenda LDK-së dhe në vështirësi në procesin e kalimit të pushtetit.

Rugova krijoi një autoritet të padiskutueshëm dhe fitoi statusin e një idhulli politik midis një pjese të mirë të shqiptarëve të Kosovës. Si udhëheqës politik ai kishte mbështetësit por edhe kundërshtarët e tij, të cilët e quanin autoritar dhe e akuzonin se Lidhjes Demokratike i mungonte demokracia e brendshme. Ai e kuptonte thellë konceptin se respektimi i të drejtave të pakicës serbe në Kosovë do të ishte me rëndësi vendimtare për ndërtimin e një shteti demokratik dhe besonte se pavarësia do të ndihmonte në zgjidhjen e këtij problemi.

...itikanët e tjerë shqiptarë, zoti Rugova shpreh shpresa ndaj Beogradit, i cili sipas tij duhet të jetë një shprehje për të ndikuar te komuniteti serb i Kosovës dhe shikonte Shtetet e Bashkuara si aleatet kryesorë të Kosovës në luftën e tyre për liri dhe demokraci. Në procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, në vitin 2000, ai mori pjesë në një seancë me pyetje-përgjigje me Komisionin amerikan për Kosovën, një ndër diskutimet më të rëndësishme organizonin ligjvënësit amerikanë për Kosovën. Në muajin maj, ai ajo kohë, ai i vizitoi shpesh Shtetet e Bashkuara dhe u përpoq të lartë dhe me përkrahje të komunitetit shqiptar, me të cilin mbante vëzhgime të ngushta. Trashëgimia e Dr. Rugovës do të jetë udhëheqësi që u përpoq të arrijë synimin e tij politik dhe të politikave paqësore në një rajon të trazur dhe lufta shihet si një nga aspektet më të rëndësishme të jetës së tij politike.

21.01.2006

Historiani Aslan Sulo del me librin e katërt

“Berat - shek. XV (Historia në defterin turk)”

Ky libër botohet me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu (1405-2005).

Libri ka për qëllim të njohë opinionin publik e posaçërisht atë të qytetit të Beratit e rrethit të tij me të dhënat që sjell “Regjistri kadastral i sanxhakut të Shqipërisë i vitit 835 h. (1431-1432), botuar nga Prof. H. Inalxhik në Ankara në vitin 1954.

Regjistri përbën një nga dokumentet më të rëndësishme për historinë politike dhe ekonomike të Shqipërisë dhe si rrjedhim dhe për trevën e Beratit në shek. XV. Ai hedh dritë mbi shtrirjen

e sundimit osman në trevat shqiptare deri në vitin 1432, mbi gjendjen ekonomike-shqoqerore të këtyre trevave, mbi shkallën e shtrirjes së sistemit osman të timareve në këto krahina, mbi popullsinë e tyre, numrin e fshatrave të kthyer në timare ose të mbetura të lira, mbi emrat e banorëve të tyre, etj.

Pjesa që i përket Beratit dhe krahinës së tij është trajtuar nga autori në bazë të përkthimit në shqip të botimit turk nga orientalisti i shquar beratas Vexhi Buharaja.


Me këtë rast i urojmë autorit krijimtari të mbarë.

Promovimi i librit u bë ditën e diel në pallatin e kulturës “Margarita Tutulani”.

Lajmëtar

Mbi 13 mijë banorë pinë ujë të ndotur në Urën Vajgurore

Ka mëse katër muaj që mbi 13 mijë banorë të qytetit Urë-Vajgurore, po vuajnë për ujin e pijshëm. Ujësjellësi i qytetit dërgon në çezmat e tyre ujë të bollshëm për disa orë në ditë. Por ky ujë nuk mund të përdoret nga banorët për asgjë. Vetë banorët të këtij qyteti të vogël thonë se ky ujë nuk mund të përdoret as për pirje, as për gatim dhe sa për larje, por vetëm për bagëti. Megjithatë ndërmarrja e ujësjellësit vazhdon të vjelë rregullisht faturat e konsumit të këtij uji. Punëtorë të ndërmarrjes thonë se ditë e fundit ka patur shumë familjarë që kanë kërkuar të prishin kontratat me ujësjellësin, por deri tani drejtuesit e tij nuk kanë pranuar asnjë rast. Shumica e familjeve e sigurojnë ujin për nevojat e tyre, duke e marrë me bidona nga ujësjellësit e Poshjes dhe Kuçovës. Banorët thonë se ky ujësjellës është shumë i vjetër. Deri në vitin '90 uji i tij ka qenë i mirë dhe kurrë nuk ishin dëgjuar ankesa nga qytetarët. Por pas këtij viti analizat e kanë nxjerrë hërë pas hërë me ndotje të ndryshme dhe sa vjen, kjo ndotje bëhet më e rrezikshme për jetën e njerzëve. Për mbi 13 mijë banorë të këtij qyteti, ky ujësjellës është i dobishëm vetëm për muajt e verës dhe në mot pa lagështi, ku sipas analizave rezultojnë i pastër dhe brenda parametrevë biokimik. Ndërsa gjatë dimrit e në mot me lagështi nga çezmat e tyre vjen ujë i ndotur me fekale dhe i turbullt. Banorët thonë se kanë mbi 4 muaj që askush nuk e përdor këtë ujë për nevoja familjare, por që kanë qenë të detyruar ta paguajnë dhe t'i mbajnë kontratat me ujësjellësin me shpresë se një ditë do të ndërhyet për të shmangur ndotjen. Ka edhe nga ata banorë që thonë se ndërmarrja apo dhe vetë drejtori i ujësjellësit e duan këtë gjendje, ndoshta se mund të kenë bërë ndonjë marrëveshje të fshehtë me interesa reciproke me shitësit e ujit të ambalazhuar në qytet. Ndërkohë drejtori i këtij ujësjellësi Abil Hoxha pranon ta thotë se uji në këtë ujësjellës turbullohet sa herë që lumi Osum ka prurje. Sepse kur prurjet e Osumit shkojnë mbi nivelin e depozitës së madhe të ujësjellësit që ndodhet pak metra larg shtratit të tij, kjo depozitë e grumbullimit dhe klorinimit mbushet me alujone. Ky fenomen ka vetëm pak muaj që ka filluar, por që vetë ndërmarrja e ka të



vështirë ta eliminojë. Ai mund të evitohet nëse ndërtohet një depozitë tjetër betoni diku larg lumit Osum. Por do të duheshin shumë fonde për ta bërë këtë. Hë për hë, thotë ai, e kemi të vështirë edhe të heqim gjanën nga depozita. Këtë e provuam pak ditë më parë duke e lënë depozitën të zbrazur 3 ditë me radhë, por ajo mbushje përsëri me ujë të turbull nga lumi Osum. Drejtori Hoxha shpjegon se ndotja e ujit në këtë ujësjellës me fekala ndodh vetëm në ditët me shira të vazhdueshëm, të cilët bëjnë bashkimin e ujërave të zeza të lagjes “Guri i Bardhë”, me rrjetin shpërndarës teje të amortizuar në atë lagje. Por ujësjellësi nuk ka fonde për rikonstruksionin e këtij rrjeti. Mjeku i qendrës shëndetësore për Urën Vajgurore Ibrahim Sadaj thotë se këtë shqetësim banorët kanë kohë që e kanë ngritur në të gjitha instancat. E vetmja gjë që na ka mbetur të bëjmë, thotë ai, është të urdhërojmë mbylljen e ujësjellësit njëherë e mirë. Ndërsa era e keqe e gazit sulfidrik që ai ka në çdo kohë vjen nga burime të ujit termal që ndodhen pranë burimit të ujësjellësit. Mjeku shpjegon se vite me parë ka patur qindra raste në fëmijë e pleq që kanë shfaqur diare. Por numri i pacientëve të prekur nga bakterit col ka ardhur në ulje, çka tregon se banorët kanë krijuar imunitet nga ky infeksion. Nga 1 janari deri dje në poliklinikën e qytetit, janë paraqitur vetëm katër fëmijë me diare. Ujësjellësi i Urës Vajgurore u ndërtua në vitet e para të sistemit komunist, me ndihmë e specialistëve jugosllavë. Për herë të parë, që nga ndërtimi i tij, shteti ndërhyri në investime për ta përmisuar pas shfaqjes së sëmundjes së kolerës në vitin 1995, ku nga ky qytet vdiq një 35-vjeçar. Shteti dha mbi 20 milionë lekë të reja për ndërtimin e depozitës së klorinimit dhe zëvendësimin e disa segmenteve në

Firmat e pezulluara nga bashkia vazhdojnë të shkatërrojnë rrugët e qytetit

Janë dy firmat Siemens dhe Diokat të cilat me kontratë nga KESH-i po vazhdojnë të shtrijnë kabllo të nëntokësorë të tensionit 20 kw në rrugët e qytetit, por që në shumë degëzime i kanë kthyer të pakalushme jo vetëm nga banorët këmbësorë, por edhe nga makinat, madje këto të fundit në disa raste duhen për t'u futur në institucionet shtetërore, pasi hyrja e tyre për rrugët është e pamundur me këmbë nga pellgjet e ujit të mbledhur në “kënetat” e krijuara para objektit shtetëror. Sipas burimeve zyrtare nga bashkia të dy firmat para fillimit të punës kanë nënshkruar një aktmarrëveshje se në të gjitha rrugët e që do hapen kanalet e shtrimit të kabllove nëntokësorë, do të kthehen në gjendjen e mëparshme. Por duket se firmat deri tani nuk e kanë zbatuar këtë marrëveshje dhe kanë vazhduar punën e tyre pa menduar për shkatërrimin e rrugëve. Në këto kushte 20 ditë më parë kryetari i bashkisë Fadil Nasufi ka thirrur në një takim firmat, të cilat kanë fituar tenderin me KESH-in dhe

u ka kërkuar që të pezullojnë punimet e mëtejshme dhe menjëherë duhet që të bëjnë riparimin e rrugëve të shkatërruara duke i kthyer ato në gjendjen e mëparshme. Por si për ironi të bashkisë dhe të kreut të saj, firmat jo vetëm që nuk kanë denjuar për t'u kthyer në riparimin e rrugëve, por kanë vazhduar punën duke shkatërruar rrugët e tjera në lagjet dhe shetitoret e qytetit. Në këto kushte kryetari i bashkisë Fadil Nasufi, i gjendur edhe përballë kritikave të shumta të banorëve të qytetit, ka urdhëruar task forcën e bashkisë që të verifikojë të gjitha rrugët dhe të urdhërojë të ndalojnë menjëherë punimin në rrugët e qytetit firmat Siemens dhe Diokat dhe të rikthehen në rikonstruksionin e rrugëve. Sipas burimeve zyrtare deri në këto momente të dy firmat nuk kanë riparuar asnjë metër rrugë, madje ajo që të bie në sy është se firmat pranë kanaletë të hapura në shumë vende kanë krijuar grumbuj çakulli të pa hapur ose të hedhur mbi kanalin e

Vodhi të dashurën, A peli e rikthen në birud,

Rreth orës 10.30 min, uniformat blu të komisarariatit të Beratit kanë rivënë në pranga, në banesën e tij në lagjen “30-vjetori” shtetasin Saimir Këlliçi. Sipas policisë arrestimi i tij u bë me vendim të gjykatës së apelit të qarkut Vlorë. Saimir Këlliçi, i datlindjes 1974, u arrestua për vjedhje në nëntor të vitit të kaluar. Ai u denoncua në polici nga e dashura e tij, banore e së njëjtës lagje, se duke qenë me të në banesën e saj, i kishte vjedhur 30 mijë lekë. Dy ditë më pasë gjykata e Beratit, kishte dhënë për të masën e sigurisë vetëm për 20 ditë burg. Por prokurori i çështjes nuk kishte qenë dakort me këtë vendim dhe e ka apeluar atë në gjykatën e Vlorës.

Vodhi lokalit, dënohet me pesë muaj burg

Gjykata e faktit në Berat, i ka dhënë fund hetimit gjyqësor kundër 19-vjeçarit Jetnor Koka, lindur dhe banues në Polican. Në përfundim të kësaj seance, trupit gjykyes e ka dënua atë me 5 muaj e 10 ditë burg, me akuzën “vjedhje të pasurisë së tjetrit”. Koka u arrestua në tetor të vitit të kaluar, si i dyshuar për vjedhjen e një lokali në periferi të qytetit të tij. Menjëherë pas arrestimit, ai e ka pranuar vjedhjen dhe një pjesë e mallrave të vjedhura, paketa, pije të ndryshme, i janë gjetur e sekuestruar nga policia. Burimet të policisë Berat thanë se Koka, do të qëndrojë në këto biruca edhe 6 ditë të tjera, pasi një pjesë të dënimit, dhënë nga gjykata, e ka shlyer nga koha e paraburgimit.

D.G.

Një ligj kundër ligjit

Shpesh e më shpesh po dëgjojmë të ngrihen zëra, ndonjëherë edhe me forcë, nga ish-pushtetarët, kundër ligjeve që kanë aprovuar vetë.

Dhe kjo e ka një shpjegim.

Kur ishin zotër të pushtetit, e kishin të drejtën e aprovimit të ligjeve që u interesonin dhe t'i formulonin ato ashtu si u interesonte, sepse kështu do t'i kishin rrugët të hapura për ndonjë allishverish. Por tani që ranë nga pushteti dhe e gjetën veten të zbuluar, u kujtuuan se këto ligje e kishin të keqen nga brenda dhe po i rrezikonin seriozisht nga dita në ditë.

E djathta dhe Partia Demokratike, që gjatë fushatës elektorale, shpallën si detyrë parësore luftën kundër korrupsionit. Dhe që të arrinin fitoren në këtë luftë, me të marrë pushtetin, do të nisnin pastrimin e rrugës nga pengesat e sajara, pra, do të nisnin luftën për përmirësimin dhe ndryshimin e ligjeve ekzistuese.

Ish-pushtetarët pikërisht kësaj lufte iu kundërvunë. Në ato raste kur ligji i vjetër i mbronte, ata këmbëngulën në moscënimin e tij dhe në ato raste kur ligji i linte të zbuluar dhe rrezikonte ndëshkimin e tyre, ata janë hedhur pa rezervë në luftë për ndryshimin e tij, duke marrë në dorë edhe flamurin e të parit që e ka ngritur këtë shqetësim, megjithëse qeveria e djathtë e ka marrë me kohë këtë nisim.

Midis atyre ligjeve që të majtë kërkojnë ndryshimin e menjëhershëm është edhe ligji për urbanistikën. Ky ligj kërkon ndryshime, kjo dihet. Këtë e ka parashtruar më parë e djathta me të ardhur në pushtet.

Po para se të bëhet ky ndryshim, duhet më parë të shihet se si është zbatuar prej të majtëve ligji i aprovuar prej tyre, të shihen shkeljet që i janë bërë këtij ligji, të ndëshkohen shkelësit ose të ndreqen gabimet e mundshme dhe pastaj të shihet mundësia ndreqjeve të ligjit në përgjithësi apo dhe të neneve të tij, të atyre ndryshimeve që ua mbyllin rrugën abuzimeve dhe jo ndryshime për t'ua hapur portën në të dy kanatat.

Pikërisht për këtë ligj, ish-pushtetarët socialistë ose edhe ata që janë ende në pushtet si kryetari i bashkisë së Tiranës, meqë kanë bërë shkelje të dukshme të ligjit ekzistues, po ngrejnë zërin në emër të pavarësisë së pushtetit vendor dhe moscënimin të kësaj pavarësie nga qeveria, që të

ndërmerret ndryshimi i menjëhershëm i tij në mënyrë që t'u vihet kapak shkeljeve. Me të drejtë Ministri Lulëzim Basha deklaroi se së pari shkelësit duhet të përgjigjen para ligjit ekzistues se janë vetë ata që e kanë aprovuar dhe që vetë duhej të bëheshin zbatues të tij, më pas të shihet mundësia e përmirësimit të tij.

Por ku duan ta dinë të majtë.

Ata thërresin: Po na cënohet pavarësia e pushtetit vendor! Nuk duhet lejuar ndërhyrja e qeverisë në të drejtat që i takojnë këtij pushteti!...

Por kjo ankesë nuk qëndron dhe as që mund të qëndrojë. Pavarësi absolute jashtë çdo mbikqyrjeje nuk mund të ketë. Se ndryshe do t'i lije hapësirë të pakufizuar korrupsionit.

Në kufijtë shtetëror të SHBA-së janë 50 shtete me qeveritë e tyre qendrore. Por në asnjë rast këto qeveri nuk mbeten jashtë vëzhgimit dhe kontrollit të pushtetit qendror.

Po kështu, edhe në BE bëjnë pjesë shtete të pavaruara që kanë hyrë me vullnetin e tyre në këtë bashkësi. Edhe këto shtete nuk kanë pavarësi të pakufizuar, nuk mund të livadhisin si të duan. Kujtoni kërcënimin që iu bë Greqisë për transparencën e buxhetit të vet.

Le të kujtojmë edhe zbulimin e korrupsionit në bashkinë e Parisit që çoi në dorëheqjen e ish-kryetarit të kësaj bashkie nga posti qeveritar.

Pra, pushteti vendor do të ketë pavarësi në përputhje me zbatimin e ligjit, ai nuk mund të lejohet të shkelë ligjin hapur dhe të mbrohet duke pasur pavarësinë së pushteteve. Qeveria ka të drejtë të vërë në lëvizje të gjitha levat për të kontrolluar veprimtarinë e pushtetit vendor, të vërë para përgjegjësisë së ligjit ata që janë shkelës të tij dhe kur e sheh të nevojshme të shtrojë për diskutim edhe përmirësimin e këtij ligji. Por më parë duhen gjykuar çështjet mbi bazën e zbatimit të ligjit ekzistues.

Vetëm kështu do t'i pritët rruga korrupsionit dhe do të vihen para përgjegjësisë së ligjit shkelësit e tij. Asnjë ish-pushtetar ose edhe pushtetar, nëse e ndien veten të pastër, s'ka pse t'i trembet asnjë lloj kontrolli. Kartat duhen mbajtur të hapura jo vetëm para qeveritarëve, por edhe para popullit që i ka votuar.

E vërteta si dhe dielli nuk mund të mbulohej.

Agim Mehqemaja

Busulla e jetës sonë

Ndodh shpesh që fjala "tranzicion" të bëhet lajtmotiv i gjërave që me zor i kapërdijmë dhe që i pranojmë nga halli që na ka rënë.

Jeta e çdo individi ka marrë një revansh që zor se mund të ndalet.

Ndjenja e "unit" e të qenurit zot mbi gjithçka dhe për çdo gjë, shpeshherë edhe në mënyrë të padrejtë, po bën që njeriu të zhvishet nga çdo etikë morale e shoqërore e të shfaqë lakuriqësinë e tij, mediokritetin, hipokrizinë. Më tepër se gjithçka sot sfera materiale ka marrë në dorë jetën e individit dhe ti kushtëzon çdo gjë, duke nënqeshur hidhur për pamundësinë e zotërimit të situatave. Realiteti shqiptar është një tablo pa ngjyra, ku zhgënjimi, mosbesimi të e ardhmja ngjall pesimizëm dhe deluzion.

Jo rrallë kam dëgjuar të shprehem se gjërat në Shqipëri ndryshojnë sa hapi i breshkës. Dhe kjo më irriton, por edhe pse më duhet të pranojë që gjërat në Shqipëri, ose më po e specifikoj, gjërat në Berat lënë shumë për të dëshiruar.

Jeta me të vërtetë është një betejë që duhet ta fitojmë çdo ditë, por në ditët e sotme e vëren me keqardhje, se jeta s'të ofron asgjë, se ëndrrat e tua bëhen pluhur e s'bëjnë gjë tjetër veçse ndotin mjedisin.

E ç'të mbetet të bësh në këtë vend ku shpirtat fisnikë i gllabëron rraliteti makabër! Besoj se ka shumë pak njerëz të ndershëm sot, sepse ndershmëria është vërtyt që po e humbasim çdo çast, e po i veshim vetvetes maskën e egër të indiferentizimit ndaj çdo gjëje e ndaj kujtdo.

Realiteti shqiptar sot është një përbindësh që gllabëron shpirtin njerëzish të ndershëm. E ç'të neget më pas në jetë kur shpirti vuan nga plagët e përbindshit?

Unë e theva heshtjen, sot po flas sepse instiktivisht e ndiej se duhet të bëjë diçka se duhet të shkruaj si pjesë përbërëse e këtij realiteti.

Sa rol luan fjala e njeriut të ndershëm, në shoqërinë e sotme shqiptare?! Po fjala e një pushtetari?! Ata vlerësohen e respektohen vetëm mbi bazën e nevojës e shpeshherë të interesit. Lejkalimi për të bërë karrierë, është domosdoshmëria e një tesere partie.

Po për ata që nuk janë anëtarë e simpatizantë të asnjë partie?!

Unë nuk kam asnjë preferencë partiake, por e dua demokracinë, si shprehje të lirisë së mendimit, respektit të qenies më të lartë, NJERIUT.

Bujar Orizaj

Njoftim për vend të lirë pune

Në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil" si dhe të urdhërit nr. 8, datë 13.01.2006, Bashkia e Beratit shpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin:

PËRGJEGJËS SEKTORI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË DREJTORINË E BURIMEVE NJERËZORE

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme në nenin 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

Kërkesat e veçanta për kandidatët:

Të ketë mbaruar arsimin e lartë.

Të ketë notë mesatare mbi 7.

Të ketë mbi 10 vjet përvojë pune.

Të ketë njohuri të programeve bazë të punës në kompjuter.

Të ketë aftësi organizuese, komunikuese me gojë dhe me shkrim.

Paga bruto:

9000+2% për çdo vit vjetërsi pune + 24084 (paga për pozicion) në muaj.

Paraqitja e dokumentave:

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 13.02.2006 në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, këto dokumenta:

Kërkesë me shkrim për aplikim.

Curriculum Vitae C.V.

Fotokopjo të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.

Çertifikatë të përbërjes familjare.

Dëshmi kualifikimi (fotokopjo e noterizuar) nëse ka.

Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.

Dëshmi i gjendjes gjyqësore.

Librezë pune.

Dëshmi nga komisioni mjekësor kompetent që vërteton aftësinë për punë.

Në datë 20.02.2006 në Bashkinë Berat do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej si dhe data e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Konkurimi do të bazohet në njohuritë mbi Kushtetutën e RSH, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin "Statusi i nëpunësit civil", ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligji nr. 9367, datë 7.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", ligjin nr. 8305, datë 30.06.1999, "Për të drejtën e informimit", Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për etikën".

Bashkia Berat

Njoftim për vend të lirë pune

Në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil" si dhe të urdhërit nr. 8, datë 13.01.2006, Bashkia e Beratit shpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin:

PËRGJEGJËS I SHËRBIMIT VETERINAR NË DREJTORINË E SHËRBIMEVE TË BASHKISË BERAT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme në nenin 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

Kërkesat e veçanta për kandidatët:

Të ketë mbaruar arsimin e lartë në Fakultetin e Veterinarisë, dega Veterinari.

Të ketë notë mesatare mbi 7.

Të ketë mbi 10 vjet përvojë pune.

Të ketë njohuri të programeve bazë të punës në kompjuter.

Të ketë aftësi organizuese, komunikuese me gojë dhe me shkrim.

Paga bruto:

9000+2% për çdo vit vjetërsi pune + 24084 (paga për pozicion) në muaj.

Paraqitja e dokumentave:

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 13.02.2006 në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore këto dokumenta:

Kërkesë me shkrim për aplikim.

Curriculum Vitae C.V.

Fotokopjo të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.

Çertifikatë të përbërjes familjare.

Dëshmi kualifikimi (fotokopjo e noterizuar) nëse ka.

Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.

Dëshmi i gjendjes gjyqësore.


Librezë pune.

Dëshmi nga komisioni mjekësor kompetent që vërteton aftësinë për punë.

Në datë 20.02.2006 në Bashkinë Berat do të shpallet lista e konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej si dhe data e testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Konkurimi do të bazohet në njohuritë mbi Kushtetutën e RSH, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin "Statusi i nëpunësit civil", ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligji nr. 9308, datë 04.11.2004, "Për shërbimin dhe inspektoriatin veterinar", ligjin nr. 9377, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Bashkia Berat




Përgatiti faqen
Bujar Orizaj

Po me të greqizuarit çdo të bëhet

Një nga prioritetet e qeverisë së re është dhe përgatitja e kartës së identitetit, si dhe pastrimet e zbardhja e librave të gjendjes civile. Kjo punë nuk do të jetë e lehtë, se tetë vjet me radhë nëpunësit e gjendjes civile, por dhe këshillat bashkëkane kanë bërë namin duke greqizuar beratas e myslimanë, por dhe të krishterë të pagëzuar me emra të tjerë grekë. Nuk janë të pakët Hajdarët, Xhemalët, Bajramët, Muhametët, Alitë, Jusufët, Braçët, Sulltanat e Mukadezët që janë bërë Jorgo, Pavlo, Koço, Stavro, Mihallaq, Vasillaq, Sofi apo Mari, etj., që vetëm për të marrë një vizë për të parë djalin a vajzën, të detyruar nga "vëllezërit" grekë, bënin të tilla makinacione, jo pa qëllim, të kërkuar nga pala greke. E keqja është se dhe zyrat e gjendjes civile, duke u shpërblyer jo pak nga hallexhinjtë, i kanë ndryshuar identitetet pa u menduar se kanë bërë një punë të kundërligjshme. Tani, këta Jusufë, Ali, Bajramë e Selamë të kthyer në grekë nga emrat e remë, por dhe të greqizuar dhe me besim tjetër fetar, si do të regjistrohen? Do të votojnë apo jo? Sa do të jetë numri real i besimtarëve të një sektit, sepse shumica figurojnë dhe të krishterë ortodoksë, por dhe myslimanë? Jemi ne qytetarët e vendit më të varfër të botës që kemi nga dy pasaporta, një për të shkuar në Greqi e një për të marrë kredi e leje për tregti. Kjo nuk do të jetë një punë e lehtë, prandaj duhet që sa më parë në zyrat e gjendjes civile të fillojë puna, por jo vetëm nga ata që kanë bërë katrahurën në librat e gjendjes civile. Nuk na ha buzza kulaq që dhe në këto regjistrime do të qartësohet gjithçka. Nuk i thonë më kot: "hedh një i marrë një gurë në lumë, mblidhen njëqint të mençur e nuk e nxjerrin dot!" A do të mbajnë përgjegjësi

Ç'bëre tetë vjet për të mbrojtur qytetin nga ndotja, zoti kryetar i bashkisë?

Kryetari i bashkisë së Urës Vajgurore u shfaq tejet i alarmuar në ekranin e një televizionit për shëndetin e banorëve të qytetit të vogël që drejton, që socialistët kanë vite me radhë që e drejtojnë. Pas '97 së famshme, ku një meritë të veçantë për realizimin e atij viti të zi, patën dhe njësitë guerile të Urës, pronarë të rinj u shfaqën në pronat e të tjerëve. U bënë pronarë më të fortët, më trimat, u bënë pronarë ata që kishin kontribuar më shumë në realizimin e planeve të hartuara në Bënjë dhe jashtë kufijve të vendit. Pronarët e ligjshëm ikën nga sytë këmbët nga hakmarrja e bashkëqytetarëve. Pronarë nëpër gurorë u bënë dhe autoritete nga Tirana, thua se ua kishte lënë i jati apo e ëma tokat në Urën e "Hasan Beut" e quajtur sot Ura Vajgurore. Tym kanë nxjerrë këto furra që nga '97 dhe përpara. Çudi, kryetari nuk donte ta shtëlliste shtetin, qeverinë e tij më saktë, me këtë shkelje




të të drejtave të njeriut, që i bëjnë ndotësit e mjedisit. Ç'i duhej kryetarit ta ngiste pamendën me tre qe? Kryetari tha se ishte ankuar në prokurori e gjyaktë, po prej një viti nuk kishte marrë përgjigje! Po pesë vjet të tjera më parë a nuk nxirrin tym këto furra? Po këto leje të paplotësuar dhe me lejen e mbrojtjes së mjedisit kush i dha dhe përse i dha?! Jo, shoku kryetar, mos luani sot me atë që qan hallin e popullit, por që nuk e paskan dëgjuar. Janë të trasha këto justifikime, lepurit ka fjetur e

flë në tjetër ferrë. Ju e kemi modelin tuaj trim e të papërkultur, kenit Edvinin e Zogut të Zi. Përse nuk bëti si ai, të merrnit fadromat e të mbyllnit bizneset që shpërndajnë kancer mushkërisë në qytetin tuaj, ashtu siç dilte ai me sopatë, për të prerë shtyllat e telefonit si në kohën e luftës partizane? Si do që të jetë, me qenë se iu futët kësaj pune, çojeni deri në fund. Mos iu ndani prokurorisë e gjykatës. Tundeni këmborën që ju kanë varur në qafë, por mos e tundni vetëm në një anë.

Letër drejtorit të KESH-it

Nuk e kam kritikuar KESH-in se e drejtojnë socialistët, por se nuk punonte mirë



Zoti drejtor, fillimisht ju uroj sukses në detyrën e re dhe shpresoj të krijoni një ekip të pastuar nga hajdutët, që nga të vegjëlit e deri te më të mëdhenjtë. Unë tërë kohën e kam kritikuar KESH-in jo se atë e drejtonin socialistët, por s'e ai ligjëronte vjedhjen e qytetarëve, duke filluar që nga afortetë e deri te mosevidentimi i familjeve që gjoja janë jashtë shtetit, por që paguajnë nën dorë faturistët. Këto familje harxhojnë me qindra kw në muaj, por paguajnë vetëm nga 1000 lekë nën dorë (ja këtu janë ato 35% të humbura në rrjet). Një vjedhje tjetër është dhe ajo që faturisti, që nga tavolina e kafenesë mbush fletoren, se sa ka konsumuar x apo y. Jo rrallë faturisti, nuk vjen në një datë të caktuar, herë 10 ditë para e herë 10 ditë prapa, por dhe kur vjen, kurrkush nga banorët e pallatit nuk e shikon me sy se sa kw ka shënuar matësi, nëse ai që ka para faturisti, ka qenë matësi yt, apo ai i fqinjit. Për të paguar energjinë duhet që të vijë fleta e nxjerrë nga kompjuteri, por që vjen shumë rrallë dhe si pa të keq të gënjejnë, të thonë: "ta


kemi sjellë, por nuk ke qenë në shtëpi. Dhe kur vjen, vjen 2-3 ditët e fundit të muajit pasardhës. Ja sot që po ju shkruaj, është data 18 janar, më 28 të këtij muaji mbyllet afati i pagesës së energjisë së muajit dhjetor, por letra nuk ka ardhur. Ndërsa kam mbyllur faturat e ujit e të telefonit, më duhet të dal prapë të mbyll atë të energjisë, kur mund t'i kisha mbyllur në një ditë. Një abuzim tjetër është me dritat e shkallës. Jo vetëm që nuk kemi, por dhe aty ku ka i është marrë nuli dhe nuk dihet se kush e përdor. Ka zanatçinj plot që të rrjepin. Zoti drejtor, kur vemi në treg, mudohejmë që të blejmë mall të mirë e jo skarco, por dhe ne blejmë të tillë, e blejmë më lirë, me çmim tjetër. Me energjinë ndryshon puna, si 220 volt, si 200, ...140 volt që nuk hyn në punë fare, e paguajmë njëlloj. Qeveria e re ka premtuar shumë gjëra të mira, por më kryesorja, luftën kundër korrupsionit. Aty ku ju kanë emëruar ju, ka patur me thes dhe që të gjithë kanë vjedhur me të dy duart, qoftë dhe indirekt duke përfutuar shpërblime për kursim

energjië në dëm të qytetarëve. Me një staf që ka vjedhur sa ka dashur dhe me punonjës shumica militantë e pa arsim përkatës, popullit që votoi për ndryshimin, nuk i shërbehet. Është detyra e juaj të njihni gjendjen në vend. Të mos u besoni se ç'ka ju thonë. Dilni pallat më pallat, takoni pronarët e çdo matësi, bëni kontrata të reja me çdo banor të pallatit prezent e jo me përfaqësues, kërkoni tërë dokumentat e nevojshme që kanë të bëjnë me çmimin e faturës, që duhet paguar dhe keni për të parë se sa humbje në rrjet janë fallo. Ashtu si deri dje, kur drejtor i KESH-it ishte një socialist dhe tani, që bëni ju kryetar i partisë ku unë bëj pjesë që në themelimin e saj, nuk do të rresht së kritikuar punën e keqe (jo të dobët, se në çdo punë ka dobësi për shkak subjektive e objektive, por për abuzime e korrupsion, unë nuk do të rresht së mbrojturi të drejtat e lirite e njeriut. Në muajin mars, do të rritet çmimi i energjisë, ky është vendim i Bankës Botërore dhe i Fondit Monetar Ndërkombëtar, prandaj dhe vjedhjet e faturistëve do të jenë më të pranishme, sepse kurrkush nga ata që janë mësuar të mos paguajnë, do të bëjnë çmos të joshin faturistët. Është detyra juaj, por dhe e policisë elektrike që ka lejuar tërë këto vjedhje që t'i ndryshoni fytyrën kësaj ndërmarrjeje, që Andis Harasani me kushurinjtë e tij ia nxu, sa që nuk ka detergjent

Një sugjerim miqësor gazetares së "Onufrit"

Në një kronikë të javës së kaluar, gazetarja e TV "Onufri", intervistoi një grup qytetarësh, duke u shtruar pyetjen: "A duhet lejuar pirja e duhanit në vendet publike?"

Shumica e përgjigjeve ishte kundër pirjes së duhanit në të tilla mjedise. E mira e të mirave do të ishte intervista në institucionet mjekësore, si në spitalin rajonal, në maternitet, në poliklinikën qendrore, në qendrat mjekësore të lagjeve, në mjediset e shkollave, në bashki e në prefekturë. Në këto mjedise pihet duhan si në derr, siç thotë populli. Bëni një vizitë në spital, sapo hyni në korridor e tij, sidomos në të dytin, aty ku presin të marrin përgjigjen e operacionit, era e nikotinës të shpon hundët. Jo më e mirë është gjendja dhe në dhomat e shtrimit, të gjithë pinë cigare. Tek-tuk ndonjë mjek bën fjalë me të sëmurin që tymos. Po kështu dhe në institucionet e tjera mjekësore gjendja nuk është më e mirë. Akoma më keq është gjendja në zyrat qeveritare, duke filluar nga bashkia e duke përfunduar në zyrat e gjendjes civile, ku ka jo pak punonjëse të modernizuara që janë bërë teraqije të kafesë në orarin e punës, por të shoqëruar me cigare. Dhe në bashki, prefekturë, qark, gjykatë e prokurori kudo pihet duhan i "hekurosur" apo i dredhur e i ndezur me masat e eshkë Tomori. Nëse duan që të ndalojmë pirjen e duhanit, fillimisht të fillojmë nga ato vende që i kemi në dorë. Në një autobus mund të ishte bërë një kronikë dhe të pyeteshin "dal vivo" (direkt) udhëtarët, që nuk e kanë për gjë që të tymosin jo vetëm ata, por të shoqëruar nga shoferi dhe faktorinoja, që nuk vjen vetëm era duhan, por dhe alkool. Aty të pyetet, përse nuk zbatojnë rregulloren e miratuar që në kohën e komandantit që na la ushtrinë pa komisarë se i dërgoi të tërë në satër.



Meqenëse që në kohën e ish-kryeministrit turist, që iku më 3 korrik, gjoja iu vu një rëndësi e veçantë pranimeve me konkurs. I sugjerimë qeverisë apo zyrtarëve të rinj, që në kërkesat për praninë në punë, të kërkohet: në mos pirja e duhanit nga kandidati, t'i bëhet e ditur se brenda institucionit si zyra, shkolla, mjedise mjekësore gjatë tetë orëve ndalohet pirja e duhanit. Kur të jetë ndaluar nëpër institucione, sidomos ato mjekësore, atëherë të kalohet kërkesa për ndalimin e duhanit nëpër mjediset publike, si bare, kafene e restorante. Kur u ndalua në Itali, më datë 10 janar 2005 pirja e duhanit, rastësisht u ndodha atje. Që më datë 10 qytetarët të edukuar me respektimin e ligjit, ndonëse e quanin të padrejtë këtë masë të qeverisë (ata që e pinin duhanin) thonin: "Jemi të detyruar të zbatojmë ligjin". Ndërsa sot, ligji për ndalimin e duhanit po futet, më mirë me thënë, po del dhe në rrugë. Nuk janë të pakët qytetarët evropianë dhe të vendeve të tjera, që kërkojnë ndalimin e pirjes së duhanit dhe në rrugën ka kalonjë ata. Kush do që të pijë duhan, le ta pijë në shtëpinë e tij, le të sëmurë fëmijët e tij.

Pra, do t'i kërkoja gazetares shoqërisht e miqësisht meqë i ka mjetet dhe mundësitë, të realizojë një kronikë në mjediset që përmenda më lart, por me pyetjen tjetër, t'u thotë direkt drejtuesve të tyre: "Përse lejohet pirja e duhanit në spitale dhe në mjediset e tjera mjekësore? Përse lejohet pirja e duhanit në zyrat e shtetit?? Pastaj mund të kërkojë mendimin e qytetarëve se a duhet të lejohet pirja e duhanit në mjediset civile."

NJOFTIM

Kush ka nevojë për t'u vizituar dhe kuruar nga sëmundje kardiovaskulare, onkologjike, gjinekologjike, ortopedike, të diabetit, të syve, veshëve, stomakut, mëlçisë dhe operacione të ndryshme në Stamboll të kontaktojë me numrin 00902125011940 nga ora 7.00-11.00 dhe 18.00-20.00.

Të shtunë dhe të diel zyra është pushim.

Kjo zyrë ju vihet në dispozicion me çmim të arsyeshëm

6 zyrtarët e implikuar në afëra dhe korrupsion, dosjet në gjykatë mes tyre edhe dy doganierë

Burime zyrtare nga organi i prokurorisë pohuan se nga ky organ janë përgatitur dosjet përkatëse për secilin zyrtar që është marrë nën hetim për përfshirjen e tij në afëra dhe në korrupsion, si dhe për ata zyrtarë që nga puna e tyre kanë përfutur persona të tretë. Të 6 zyrtarët janë denocuar nga qytetarët, kontrolli i shtetit dhe nga kontrollë të rastësishme të policisë. Po i njëjti burim tha për gazetën se për këta zyrtarë dosjet e tyre do të mbërrijnë në gjykatën e faktit ku dhe do t'i nënshtrihen gjykimit. Burime nga organi i prokurorisë thanë se mes 6 zyrtarëve, janë


edhe dy doganierët D.V dhe A.K., të cilët kanë ulur vlefëtin e makinave duke ulur edhe vlefëtin e zhdoganimit nga kanë përfutur persona të tretë. Por ka pasur edhe zyrtarë që janë përfshirë në afëra dhe korrupsion direkt, duke përfutur edhe shuma lekësh që për organin hetimor emrat e tyre nuk bëhen të ditur për arsye hetimi dhe se ende ka persona të tjerë të përfshirë në këto afëra dhe korrupsion si bashku me ta, por që janë ende jashtë dosjet të hetimit. Raste të përfshirjes në korrupsion ka pasur edhe në institucionet shtetërore të disa ndërmarrjeve dhe

institucioneve të cilat kanë punuar me dy llogari, njëren prej të cilave private dhe tjetren shtetërore. Ogani i prokurorisë ka nën hetim edhe dosjet e dërguara në këtë organ nga krimi ekonomik, dosje të cilat do t'u vihen në dispozicion për hetim oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të çështjeve. Në hetim do të merren veç zyrtarëve edhe krerët e disa firmave, të cilët kanë dosje hetimore nga krimi ekonomik për projektet e mosrealizuara dhe punën me cilësi të dobët të vërtur nga grupet e kontrollit. Burimi nga organi i prokurorisë tha për gazetën se të gjitha dosjet janë në procesin e fundit hetimor dhe se shpejti do të ketë edhe fletë-arresti për rastet konkrete që plotësojnë këto kushte.

Dorina Gozhina

Xhamia 350-vjeçare drejt shkatërrimit të plotë

Në ditën Bajramit besimtarët falen jashtë mureve të xhamisë



Xhamia 350-vjeçare e ndërtuar në vitin 1660 nga Veziri i Madh, Mehmet Qypërliu, i cili e mori këtë detyrë në moshën 80-vjeçare dhe e drejtoi portën e lartë për pesë vjet duke e ringritur edhe njëherë perandorinë, e cila deri në atë kohë, para marrjes së detyrës së Vezirit të Madh prej tij, ishte drejt rrënimt. Mehmet Qypërliu me orgjinë nga fshati Roshnik nuk e harroi asnjëherë vendlindjen e tij dhe krahas ndërtimeve të tjera që ka bërë si në drejtim të fortifikimit të kalasë së Beratit, ka ndërtuar në fshatin e komunës së përbëhet nga 12 fshatra me një popullsi prej rreth 4 mijë banorë. Në këtë zonë xhamia e Roshnikut është i vetmi objekt kulti, e cila ka funksionuar si e tillë deri në vitin 1967, kohë kur objektet e kultit në të gjithë vendin pushuan aktivitetet e tyre fetare. Kjo është ndër të vetmet xhami në zonë që, ndonëse ka ngelur në mëshirë të fatit, i ruan të gjitha

elementet që i takojnë një objekti kulti, ndryshe nga xhamitë e tjera në këtë zonë të cilave tani u dihet vetëm vendi se ku kanë qënë ndërtuar, pasi si objekte ato janë zhdukur tërësisht. Edhe pse ky objekt është i vetmi në këtë zonë, sikur të mos mjaftonte pesha e viteve që mban mbi supë, ajo tashmë mban edhe indife-rencën e institucioneve të besimit islam dhe strukturave të tjera përkatëse, të cilat po e çojnë drejt shkatërrimit. Xhamia e ndodhur në qendër të fshatit Roshnik, e përballur me agjentë atmosferikë, ka mundur t'i sfidojë ata dhe për këtë falë strukturës dhe cilësisë së mureve të saj, ajo nuk ka pësuar asnjë dëmtim në këto mure, por ajo që e nxjerr jashtë funksionit këtë objekt është mungesa e dyerve dhe dritareve si dhe shëmbja e çatisë së saj. Sipas banorëve të zonës, kjo xhami deri në vitet '67 ka qënë në gjendje shumë të mirë dhe këtu kryenin ritet e besimit islam dhe faleshin rreth 10 mijë banorë të zonës së Roshnikut dhe fshatrave përreth. Në vitin 1967 kjo xhami pushoi së qeni e tillë dhe që atëherë deri në vitin '90 ka shërbyer si magazinë për kooperativën. Sikur mos të mjaftonte tjetërsimi që iu bë xhamisë në

vitin 1967, me ndryshimin e sistemit në vitin 1990 ajo po provon një tjetër "persekucion", atë të rrënimt dhe zhdukjes nga faqja e dheut. Banori i fshatit Roshnik Esat Mimani shprehet për gazetën "Lajmëtar": "E kemi shumë të nevojshme riparimin e kësaj xhamie jo vetëm për të kryer ritet e besimit tonë, por edhe sepse kjo xhami është një monument kulture që flet për historinë dhe figurat e mëdha historike që ka nxjerrë ky fshat. Ne si çdo vit tjetër edhe nesër në ditën e Bajramit do të falemi jashtë mureve të saj, pasi brenda ajo është inekzistente".


"Besimtarët e kësaj zonë kanë rënë dakort që edhe vetë ata të kontribuojnë duke vënë një pjesë të lekëve për ta kthyer në indentitet dhe për ta bërë atë funksionale. Kthimi i saj në identitet sipas sekretarit të këshillit të komunës, mësuësit të historisë z. Fadil Kalanxhiu, kërkon një shumë të konsiderueshme financimi të cilën, me të ardhurat tona, ne nuk e përballojmë dot, prandaj për këtë problem kemi shkuar tri herë në myftininë e Beratit me qëllim që edhe ata të na ndihmojnë si me planin e ristrukturimit, ashtu edhe nga ana financiare, por që deri tani nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ana e myftinisë

Shkëndija elektrike shkrumbon shtëpinë

Ka qënë një shkëndijë elektrike dhe rrjeti tejet i amortizuar që i ka dhënë mundësi të kthehet në një "përbindësh", i cili për pak orë e ka kthyer shtëpinë e shtetasit Haki Kane nga fshati Vodicë i komunës Vërtop në një gërmadhë duke djegur gjithëçka që ndodhe brenda banesës. Sipas dëshmitarëve okularë zjarri ka filluar nga çatia e shtëpisë dhe më pas ka përfshirë të gjithë banesën, e cila përbëhej nga dy dhoma dhe një kuzhinë.

Ngjarja:


Ngjarja e rëndë ka ndodhur rreth orës 18.30 në fshatin Vodicë komuna Vërtop, rreth 10 km larg nga qyteti i Beratit, kohë kur pronari i banesës Haki Kane, së bashku me bashkëshorten e tij Thëllencën dhe dy fëmijët Armendin dhe Fabionin, përkatesisht 12 dhe 8 vjeç kishin shkuar për një vizitë te babai i Hakiut, Petriti, i cili banon në të njëjtën lagje me Hakiun. Rreth orës 19.00, njëri nga komshinjtë e 41-vjeçarit Haki Kane, ka shkuar i tmerruar në shtëpinë e babit të tij, Petritit, dhe, pasi ka hyrë brenda, u ka thënë atyre se shtëpia e Hakiut ishte përfshirë nga flakët. Menjëherë pas njoftimit të gjithë familjarët, të ndihmuar edhe nga bashkëfshatarët të tjerë kanë shkuar për të fikur zjarrin, por gjithëçka kishte marrë fund në harkun kohor prej një ore . Shtëpia 30-vjeçare, me një çati me lëndë drusore tepër të thatë dhe të ndjeshme ndaj zjarrit, ka bërë që flaka të përparojë me shpejtësi dhe të zaptojë të gjithë



banesën. Drurët e ndezur që binin nga çatia e shtëpisë kanë shkrumbuar të gjitha orënditë si, rroba fjetjeje, veshmbathie, televizor, frigorifer, lavatriçe, etj.

"U hutuam dhe nuk denim se çfarë të bënim, – thotë i zoti i shtëpisë Hakiu, - u përpoqëm që zjarrin ta shuanim me kova me ujë, por kjo ishte e pamundur. Më pas njoftuam zjarrfikësit, të cilët erdhën shumë shpejt, por zjarri në këtë kohë e kishte bërë punën e vetë në shtëpinë time, ndaj zjarrfikësit bënë vetëm lokalizimin e zjarrit që ai të mos përhapej më tej në lagje". Kryetari i komunës Vërtop Flamur Balliu, i cili ishte në vendngjarje, u shpreh për gazetën "Lajmëtar": "Kemi ngritur një komision dhe menjëherë do të fillojmë nga puna për përgatitjen e dokumentave dhe më pas do të japim maksimumin e mundshëm nga buxheti i komunës për këtë familje në nevojë".

Intervistë me të dëmtuarin:



Çfarë bërët më pas?

Dikush nga ne tha se duhet të njoftojmë menjëherë zjarrfikësin për të kufizuar flakët që të mos përhapeshin në të gjithë lagjen. Dhe kështu bëmë, njoftuam zjarrfikësit, të cilët erdhën shumë shpejt, pasi ne jemi shumë afër qytetit të Beratit, por në banesën time flaka kishte bërë të vetën. Zjarrfikësit sapo mbërritën filluan nga puna duke lokalizuar flakët vetëm në banesën time dhe kështu bënë të mundur që ato të mos përhapeshin më tej në lagje.

Ç' mundë të shpëtosh nga djegia?

Nuk munda të shpëtoj asgjë, pasi flakët kishin përpërë gjithëçka. Tani ne kemi vetëm rrobat e trupit dhe asgjë më tepër. Ndoshtemi në qiell të hapur dhe nuk di se nga ta filloj. Akoma më duket vetka sikur jam në një ëndërr të keqe.

Ç' ndihmë do t'i kërkonit komunës?


Jo vetëm komunës, por kërkojmë ndihmë të gjithë të afërmit tanë, bashkëfshatarët, shoqatat, etj, që të mendojnë për familjen dhe dy fëmijët e mi, të cilëve u kanë mbetur vetëm rrobat e trupit dhe tani ata nuk kanë asgjë, ju mungojnë librat dhe gjithëçka. Presim të na ndihmojnë të gjithë ata që mundën, pasi ndodhemi në një gjendje tepër të vështirë ku na mungon gjithëçka.

Zoti Haki, ku ndodheshit kur dëgjuat se shtëpia juaj ishte përfshirë nga flakët?

Me bashkëshorten dhe dy fëmijët kisha shkuar për një vizitë te babai im, Petriti, pasi jemi shumë afër dhe shkojmë shpesh te njëri-tjetri. Rreth orës 19:00 dëgjua që dikush po bërtiste nga jashtë shtëpisë. Ishte komshia, i cili më pas hyri në shtëpinë e babait ku unë ndodhesha dhe na tha se shtëpia ime ishte përfshirë nga flakët. U ngritëm të gjithë për të shkuar atje. Në ndihmë na erdhën dhe bashkëfshatarët e tjerë, por flaka kishte përfshirë të gjithë shtëpinë dhe uji që ne hidhnim me kova nga poshtë dukej sikur e ndihmonte edhe më tepër atë.

Ese nga Ervin Hatibi

Që feja t'i kthehet vërtet Zotit



Ervin Hatibi

Gjatë gjithë dekadës së fundit kemi mundur të shohim gati në krejt hapësirën shqiptare lehtësinë me të cilën diskutohet për fenë. Në këtë diskutim përfshihet gjithkush, si të ishte diskutimi një pishinë publike, në katër cepat e së cilës hidhen zhurmshëm kalamaj parashkollorë; (jo se dinë të notojnë, por zbatojnë parimin e vjetër që thotë "pa u futur në ujë, nuk e mëson notin"...); (...plus që edhe pishina e diskutimit është vetë e cekët, e ta lejon amatorizmin, e në këtë mënyrë edhe protagonizmin). Të gjithë mund të bëjnë si kampionë oqeanikë në këtë terren ujëpak, dhe bile, meqë nuk është rënë ende dakord as për termat e garës, të katër anët e diskutimit janë edhe cak edhe fillim edhe fund edhe mësi i tij... Fajin për këtë tollvi për së pari e ka dobia e mirënjohur e hoxhallarëve dhe priftërinjve tanë, të cilët vetë nuk po i thellojnë përmasat e diskutimit dhe nuk po caktojnë qartas dhe dukshëm limitet.

Në përgjithësi, në diskutimet publike të dekadës së fundit, jofetarët që kanë patur monopolin e këtij diskutimi, haptas kanë guxuar të identifikojnë të keqen e kombit me fenë. Përjashtoj nga jofetarët vetëm ateistët e ndershëm fundamentalistë, (të cilët në esencë nuk pajtohen me aspektin joracional të fesë), pjesa tjetër e tyre nuk pajtohet me aspektin jonacional që kanë esencialisht besimet fetare. Kjo sipas tyre na pengon unitetin, së këndejmi edhe prosperitetin. Kështu, meqë projekti "feja e shqiptarit është shqiptaria" përveçsi si metaforë patriotike e një konteksti të caktuar historik nuk pati fatin të marrë formën e ndonjë sinkretizmi të vërtetë religjioz, atëherë jofetarët kanë rëndur të zgjedhin në mënyrë kriminale njëherë prej feve, në kurriz të tjetrës, si përfaqësuese të përbashkët të projekteve nacionale. Të mos i largohemi idesë që thashë më lart, se ata vërtet kanë identifikuar, një palë Islamit e një palë krishterimit, me të keqen e kombit. Ata që thanë se muslimanët kanë fenë e pushtuesit, apo se ekzistenca e tyre na ndan nga Evropa dhe zhvillimi, a nuk ia kanë arritur me sukses ta portretizojnë Islamit si të keq për shqiptarët? Ata që kanë mbështetur se shqiptarët janë bërë muslimanë duke shpëtuar shqiptarinë nga krishterimi që ua rrezikonte, a nuk kanë fyer allëgjatë kështu fenë e të krishterëve shqiptarë, (që kanë mbetur të krishterë e shqiptarë edhe sot e kësaj dite)? Në këtë diskutim jofetar mbi fetë, argumenti shterues pse Islami "është i mirë" për ne, qëndron në faktin se ai na mundësoi të mbetemi shqiptarë në një det ortodoks sllavo-grek, kurse argumenti paralel pse krishterimi për ne "është i mirë" lidhet me faktin se kjo është feja e Perëndimit të fuqishëm dhe të qytetëruar. Misionarët e parë të krishterimit ndër shqiptarët, sigurisht përmendim Perëndinë dhe jo Perëndimin, ashtu si edhe imamët e dervishët që thërrisin popullin në Islam, kur flitnin për parajsën, nuk kishin ndërmend ndonjë utopi tokësore nacionaliste të Shqipërisë së Madhe... Ama sot, zëdhënësit e palinçensuar të të dyja feve i kanë tokëzuar e privatizuar qëllimet e shenja. Të grumbulluar një palë rreth diskutit pseudofetar të integritetit kombëtar, e pala tjetër rreth një tjetri (diskurs pseudofetar po aq bosh) të integritetit ndërkombëtar, tentojnë të zyrtarizojnë midis shoqërisë tonë monumente monstruoze të fesë së politizuar e instrumentalizuar, të ngritura më dukshëm se minaret dhe këmbanoret. Personazhe të tillë janë vetë tashmë priftahoxhë të feve gjeopolitikisht korrekte, pasi i kanë shmangur nga loja besimtarët apo njerëzit e fesë me ca marifete futbollistike mbi terrenet tepër delikate të religjiozes, ku si minimum duhen hequr këpucët me baltë para se të shkelësh. Atyre, besimtarët a njerëzit e fesë u duhen thjeshtë si një element në dekorin e reputacionit, e mund t'u duhen edhe si mburoja njerëzore në besimit, i ndjeshëm ndaj alkimiisë së retorikave dhe grupuese, ka rezultuar frytdhënës për t'u marrë në duar dhe biznesit. Ashtu si në fshatrat e varfëra të shqiptarëve, përtej kallinjve të misrit maskohet kana e politikës dhe tregatit kërkohet një përkrahje e mbjella e për t'u shprehur në grupimi të konsumatorit si blerës-konsumator në marketing... Të korra korrisit më të shumtë... Nëse prijësit fetar për fenë si fe, nëse nuk e dallojnë haptas bënë "hesape elektorale" me numrin e evaziv perimetrin identifikues të xhamisë

për ata që nuk e besojnë Zotin, (a thua se Zoti ka nevojë për njerëzit e jo e kundërta), apo nëse u vjen ëmbël kur njerëz a grupe të fuqishme jofetare bëhen artikule të interesave fetare, atëherë të mos u vijë hidhur nëse nesër e gjitha kjo prodhon përfshirje të paparamenduara në konflikte apo përçarje interesash në shoqëri. Të cilat kaq pak kanë lidhje me fenë. Në kohën kur dekomunistizimi i shoqërisë shqiptare është një proces që megjithëse përpëlitet, ka hyrë në një rrjedhë, është tashmë detyrë e çdo besimtarit shqiptar të nisë e të kontribuojë edhe për de-ateizimin e fesë, përzënia me ceremoni të tregtarëve nga tempulli, flakjen tej të gjithë mbishtresave koniukturale interesaxhije jashtëfetare prej ambientit dhe diskutit fetar. Që feja t'i kthehet vërtet Zotit, që të mos tallen më me të, që të mos ta akuzojnë më se është një sajësë narko-politike e kastave të larta, për të përmbajtur nënshtruar të ultat...

Përveç rastit kur debati publik mbi kryesinë e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare u dominua brutalisht nga njerëz jofetarë të traditës joortodokse, duhet thënë se bashkësia dhe feja absolutisht më e abuzuar dhe sulmuar tek ne është ajo e muslimanëve. Është fakt i njohur nga të gjithë, se përherë muslimanët shqiptarë goditen për faj të supozuara të njerëzve të tjerë (psh. për faj të turkut që na pushtoi gjysëmijëvjeçari më parë, apo për faj të arabëve që hedhin bomba nëpër botë.) Mendimtarë dhe figura të njohura e më pak të njohura, nuk kanë ngurruar të ftojnë shqiptarët haptas të divorcohen me... veten e tyre, të kthejnë fenë dhe gunën nga fryn era, dhe të arrijnë kështu Perëndimin, meqë edhe era për andej frynka. Kanë tallur, stigmatizuar apo përprekur të fshehin traditën dhe kontributin e muslimanëve shqiptarë, janë shërbyer në retorikën e vet me racizëm, ksenofobi orientaliste e fashiste; dhe e gjitha kjo jo nëpër fletushka të nëndeshme si traktet famëkeqe të Kosovës, jo në site interneti të ndaluara, por krejt haptas e krenarisht në tubime e botime të respektuara... Sipas mendimit tim, sidomos në Shqipëri, kur hapja nënkuptoi edhe hapje të xhamive, retorika demonizuese dhe përjashtuese ndaj Islamit, mëshonte më tepër tek preventivonin përmas sulmit, duke bërë lidhje midis elementëve të parë të rishfaqjes së Islamit në publik, me legjendat e eksperiencës nën turkun, apo me paralelet me terrorizimin ndërkombëtar për të nënvizuar në të gjitha rastet dhunën, obskurantizmin. Sot, pas më se një dekade, kur listën e grupmoshave nëpër xhami gjithnjë e më tepër po e mbizotëron rinia, nuk bëhet më fjalë që retorika islamofobe të jetë e tipit çrënjosës si në fillim, por ka marrë tashmë karakter krasitës dhe frenues. Po ata mendimtarë që deri dje e shihnin islamizimin e shqiptarëve si një aksident historik, si një gabim për t'u korrigjuar, si një devijancë që i kishte ndodhur popullit tonë gjatë fazës së vet "pubertive", po të njëjtit mendimtarë i gjen sot duke mbrojtur "islamit tradicional shqiptar" nga tendencat e huaja për radikalizim dhe arabizim. Pa delikatesë, muslimanëve të sotëm shqiptarë u thuhet se për ne, si një popull joreligjioz (!?), pranimi i Islamit ka qenë administrativ dhe strategjik, dhe kështu duhet të mbesë, se prishet tradita. Duke shpikur një "islam shqiptar" ku nënkuptohet kryesisht mungesa e ritualeve të dukshme dhe e aktivizimit shoqëror, kjo krijesë mitologjike i kundërvihet "islamit të arabizuar", pra shembullit të një pjese të besimtarëve praktikantë, e cila pa shkelur asnjëlligji ligji të shtetit apo të fesë, pëlqen një stil "alternativ" jetese në sjellje, veshje, ushqim, argëtim etj. Stil i cili në fakt është jo thjesht më afër traditës shqiptare, por në shumicën e rasteve, është mbasë i vetmi shembull i gjallë i kësaj tradite. Duke na trembur me "arabizimin e Islamit" i cili do na bëjë si Lindja e Mesme, mbështetësit jofetarë të "tradicionalizmit islam" na ofrojnë si shembull të "islamit vendas" disa dëshmi udhëtarësh qëllim evropianë të shekullit të XIX, ku përshkruhen veshje ekzotike shqiptarësh të çuditshëm që shkojnë edhe në kishë edhe në xhami... (Ato kohë në fakt ka patur edhe literaturë që tregonte se shqiptarët përveç vijës së zezë "etnografike" mbi tirçe apo xhedikët e lehtë, kishin edhe nga një bisht të gjatë si majmunë pas vetes.) "Tradicionalistëve islamikë" u duhen këto lloj dëshmi për stabilitet fetar të shqiptarët, për mungesë të dogmës dhe përditshmërisë fetare tek ta etj. Atyre nuk u mjaftojnë dëshmitë e parreshtura nëpër shekuj që tregojnë se përherë shqiptarët muslimanë kanë thirrur ezan e kanë mbajtur ramazan, se gratë kanë mbuluar flokët, dhe të përkuftuarit kanë rritur mjekërr, se kanë kënduar Kur'an arabisht e kanë lexuar vjersha persisht... Por edhe nëse do të binim dakord me vizionin e tyre të "islamit shqiptar", prapë ata, në mënyrë krejt të pashpjegueshme i dashkan muslimanët shqiptarë muzealë, të pandryshueshëm. Në kohën e sotme, kur asnjë grupim apo bashkësi jo vetëm shqiptare, nuk mund të thotë se është e njëjtë jo më me një shekull më parë, por as me një dekadë, "konservatorët" tanë i duan muslimanët shqiptarë të vaksinuar ndaj çdo lëvizjeje të natyrshme apo rileximi në fenë islame, siç ka ndodhur historikisht në këtë fe.

Por, megjithë shfaqjen e "tradicionalistëve" në horizontin e kritikëve ndaj "problemit islamik", veç "çrënjosësve" të kurdonodhur që ende flenë me platforma rikonvertimesh masive, një lloj tjetër i ri islamofobie po mund të vërehet. Nëse

"tradicionalistët" pranojnë gjithsesi një lloj Islami shqiptar të së shkuarës, vetëm të përshkruar por jo të dokumentuar (si një lloj Atlantide), nëse kemi ende edhe radikalët "çrënjosës" që përmendim me zë të lartë Rekonkistin, një rrymë tjetër "riformatuese", (jo reformuese) po kërkon një "islam evropian" të së ardhmes. Vini re! Nuk është projekti gjithsesi-ortodoks i Tarik Ramadanit, nuk janë vizionet natyralizuese të diplomatit Murad Hofman, apo të eruditit Timothy (Abdal-Hakim) Winter a të tjerëve mendimtarë muslimanë, përmbi normalitetin e të jetuarit si musliman evropian. Janë tentativa nga jashtë Islamit, për të parë probleme brenda trupit të fesë dhe për t'i ndrequr ato për shkaqe politiko-ekonomike, të pagëzura si shkaqe "evropiane". Se ndryshe ç'siklet do t'i shtyjë njerëz me plot punë të tjera t'i hyjnë, (pa formimin dhe përkushtimin e duhur) profesionit të reformatorit fetar...

Në formën e një parathënie, ky projekt u duk sipas meje për herë të parë tek ne në një debat për çështje të Islamit të shqiptarëve, organizuar nga televizioni "Klan", ku intelektualit dhe politikani i njohur Arbër Xhaferri shpjegoi se tashmë pas "evropianizimit të krishterimit" radha po i vinte edhe Islamit të evropianizimit në Kontinentin e Vjetër. (E keqja dhe e pavolitshmja si përherë janë lindore; kështu kishin qenë edhe në krishterim deri sa ky erdhi në Evropë.) Sipas z. Xhaferri, e kaluara paraglobaliste, ofronte paisazhin idilik e adhetar të hoxhës e priftit nga fshati, kurse sot ky paisazh po kompromentohej nga të shkolluarit në vendet arabe, vende këto të prapamotura dhe politikisht anakronike. Këtë anakronizim politik (ribashkimin e kishës me shtetin) kërkufizuar ta fusin tek ne bashkë me fenë, të shkolluarit e Arabisë. Këtu tek rreziku i "arabizimit" të politikës (jo të Islamit pra; të paktën ta thonë kështu dhe ta lënë fenë rehat), puqet shqetësimi i tre shkollave, pra edhe "tradicionalistëve", edhe "çrënjosësve" edhe "euroislamikeve". (Ashtu si kam parur rastin ta bëj edhe herë të tjera, do sugjeroja që feja të shihej me koherencën e vet, me paradigmen dhe me termat e qëllimit e saj si një tërësi dhe të mos copëzohet në detaje që hetohen me optika politizuese, sepse mu këto e nxisin profilizimin politik të fesë.)

Duke e parë ndërgjegjen njerëzore si të ndërtuar mbi dy elementë (dualizimi i vjetër, bardheziqja e famshme), intelektualit Xhaferri në mënyrë shumë anatomike, u përfshi dashur pa dashur në frymën e "përplasjes së qytetërimeve". Sipas leximit të tij këta dy elementë që flenë ndër ne të gjithë, qenkan elementi "profashist" (asnjëherë nuk e di njeriu i shkretë sa të zezë mbaka në bark...) si edhe elementi i dashurisë. I pari neve na jep impulset e dhunës dhe të komandimit, shtetformimit etj, kurse i dyti nuk do fort koment. Në këtë raport manikeist engjëll/djall, eros/thanatos, jin/jang, lindje/përdim, Xhaferri tha se në krishterim ka fituar dukshëm dashuria dhe pastaj çuditërisht nuk përmendi si qëndron jo punë me Islamit, për të cilin zhvillohej edhe emisioni. Heshnja e tij, pasi kishte përmendur më parë botën arabe ku feja (dashuria) nuk është ndarë ende bindshëm nga shteti (profashizmi), nënkuptoi për fenë tjetër një përkufizim ose me më pak dashuri dhe më shumë "proto...", ose (duke e shfaqësuar) një raport barazie midis këtyre dy elementëve. (Por pjesën tjetër të heshjtjes e mbshte dijenia se në shtypin botëror prej kohësh lundrojnë bollshëm termat "fashizëm jeshil", "islamofashizëm" për të përkufizuar ca trende të sotme të muslimanëve.) Fatmirësisht, niveli i të shprehurit të zotit Xhaferri, ishte vërtet tepër i lartë, dhe shpesh jo se shumica e shikuesve të emisionit të shumëndjequr "Opinion", si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë nuk e kanë marrë dot promesazhin e tij. Dhe prapë fatmirësisht, ata që munden ta zbrërthejnë eloquencën intelektuale të z.Xhaferri, janë njerëz që nuk ndikohen aq lehtë.

Vështrime që shohin tek Islami si fe pamundësi dhe papajteshmëri dhe nevojë për kirurgji, vështrime që duan të përmblidin në trupin e fesë jo vetëm shkrimet e shenja dhe shembullin profetik, por edhe kronikën e zezë të gazetave, vështrime që e gjykojnë Islamit jo nën dritën e hershme të Mekës e Medinës por nën zjarret e New Yorkut e Tel Avivit, vështrimet që duan t'i shohin të këqijat dhe teprimet e personave apo grupeve të caktuara si burimore nga Islami, vështrime të tilla sot është rënë dakord në të katër anët e botës të quhen islamofobi. Askush në fakt nuk mund të pengohet që të kultivojë në kraharorin e vet bistakët e profashizmit, antisemitizmit, islamofobisë, islamofashizmit etj.etj, por nën dritën e diellit, e sidomos nën atë të skenës lipeset demonstruar një minimum hipokrizie postmoderne pranimi dhe respekti për tjetrin, si nevojë për të vijuar bashkëjetesën nëpër shoqëri pluraliste. Nëse edhe ky minimum, i domosdoshëm si themi, do të mungojë, uji dhe mielli do të shkapërdahen dhe buka e përditshme e bashkëjetesës nuk do të mbruhet më. Por, edhe ky është një opion mbase...

Sigurisht, çdokush ka lirin e vet dhe copyright-in e vet për termat dhe projektet e veta. Por të gjithë ata që diskutojnë për fenë, tek e fundit duhet ta dijnë se xhamitë edhe kishat kanë edhe dyer, përveç dritareve nga ku njerëz të ndryshëm, pa i

Ngjarja e Patosit apelon Jeta jepet vetëm një herë, ajo nuk është telenovelë

Kohët e fundit, opinioni publik është njohur me ngjarjen tragjike të dy të rinjve në një shkollë të Patosit, ku njëri prej tyre mbeti i vrarë nga shoku i tij. Si qytetar dhe prind kjo ngjarje më ka tronditur, sepse pa asnjë shkak i merret jeta tjetrit si zog në fluturim. Jeta secilit i jepet vetëm një herë dhe duhet administruar, në funksion të familjes, shoqërisë, shtetit dhe nuk mund të vlerësohet si telenovelë. Pas ngjarjes së Patosit, në shkollën "Lefter Talo" ndoqa dhe opinionin e forumit rinor të Fierit, disa nga nxënësit dhe mësuesit okular në ngjarje dhe vura re prekjen e tyre në fytyrë dhe nga mënyra se si shpreheshin dhe kjo me të drejtë, sepse njëri prej të rinjve u vra nga një dorë kriminale pavarësisht motivit, por u shua një jetë, e cila me të mirat dhe këqijat, duhet të vazhdojë. Është për t'u çuditur se sa herë ndodhin gjëra të pakëndshme, sidomos në shkollë, persona të veçantë gjithë fajin ia hedhin asaj, pra shkollës. E keqja është se si nxënësit, por dhe një pjesë e prindërve bëhen të durueshëm dhe nuk pranojnë t'u kujtosh të metat dhe kur këto të fundit u vihen në dukje. Kjo ka bërë në disa raste që moshë adoleshente, të ndërmarrë hapa të nxitura deri në ekstrem siç ishte rasti i fundit, ai i Patosit që përfundoi me vrasje, pavarësisht motivit.

Shtrojmë pyetjen: ç'mund të bëjë një nxënës i kujtoda viti apo klase qoftë, kur dëgjon nga goja e prindërve të tij që i del në mbrojtje për sjelljen e tij në shkollë kur s'e di mënyrën e sjelljes së tij për kohën që është në shkollë ose konvikt? Pra, më mirë se kushdo këtë e di mësuesi kujdestar, ose kujdestari i konviktit kur është konvikt. Por nuk mund të themi se për sjelljen e djalit apo vajzës e ka fajin shkolla, e cila mban përgjegjësi për kohën që është në mësim ose në konvikt. Por kur nxënësi ikën nga ora e mësimit apo konvikti, këtu ka faktorë të tjerë që ndikojnë që nga edukata që ka marrë në familje, pa thënë se një pjesë të tyre u është dhënë e drejta e studimit gabimisht.

Unë trajtova vetëm një shembull konkret, por ka raste që prindërit e kanë të vështirë të pranojnë se fëmija e tij nuk është në paramentrat e duhur, qofshin në shkollat 9-vjeçare dhe ato të mesme. Qëndrimi i disa prej tyre më kujton një thënie të Mithat Frashërit, i cili ka theksuar: "Shqiptarit nuk i pëlqen kurrë që të shohë dhe të njohë fajin dhe të metën e tij, por i pëlqen kurdoherë të ngarkojë të tjerët". Në sjelljen e fëmijëve duhet të shohim ndikimin e prindërve, pasi kohën më të madhe ata e kalojnë pranë familjes së tyre. Për nxënësit dhe fëmijët në përgjithësi, prindërit janë pasqyrë e tyre. Shoqëria i do fëmijët të denjë, për të dhe për vete, pa vese, pa kapriçio të brendshme të moshës. Një fëmijë i rritur me ndjenjë qytetare është i dobishëm jo vetëm për veten e tij, por dhe shoqërinë. Një shkrimtar i huaj duke folur për dhunën dhe edukimin e fëmijëve në shkollë shprehet: "Nënë, mos harro se fëmijët nuk të përkasin vetëm ty. Ata i përkasin tokës ku kanë lindur dhe shoqërisë ku jetojnë. Kemi mbi pesëmbëdhjetë vjet demokraci dhe në jo pak raste, krimet kanë ndodhur nga moshat e brishta, për motive fare banale.

Mos duhet që dhe shteti të mbleddhë rripat dhe të harrojë për rrushfetet, tarafilëkun në radhët atyre që merren me zbatimin e ligjit?

Mos ndoshta ka ardhur koha që të harrojmë për pak kohë se rrethohemi nga njerëz që kërkohen zbutjen e ligjit dhe të kthejnë këtë vend në shtet kanunor dhe jo ligjor? E theksojmë këtë, se të gjithë politikanët në fushata të ndryshme trumbetojnë me të madhe për një shtet ligjor dhe demokratik, një shtet të drejtë dhe të barabartë.


Mësues sinonim i fjalës njeri

U ndodha pranë shkollës së mesme artistike "Ajet Xhindole", sepse doja të takoja mësuesen e ciklit të ulët të klasës së 4-t, zonjën V. Malasi.

E thjeshtë, me një fytyrë të një mësueseje-prind, ajo m'u duk në atë çast një fisnike, e cila sikur thoshte në heshtje, "mësuesi është sinonim i fjalës njeri".

Ky shikim e komunikim më solli në kujtesë fjalët e akademikut, Mësuesit të Popullit, pedagogut tim të paharruar, zotit Jup Kastrioti, i cili thoshte: "Në radhë të parë, fëmijët e mi, ju duhet të jeni me virtyte njerëzore në jetë, që të mbeteni mësues të mirë, sa të respektuar e të nderuar".

Këtë e pashë, e gjeta te kjo mësuese, e cila nesër merr rrugë për në spitalin ushtarak me një grup nxënësish të klasës për të takuar nxënësin e vet K. Azizolli, i cili para




ketë marrë një kokërr bostan. Opinioni i sotëm e di mirë se ne nuk vuajmë nga mungesa e ligjeve, por nga moszbatimi i tyre.

E ndoqa me interes arrestimin e djalit që vrau shokun e tij në shkollën "Lefter Talo" në Patos, i cili nga pamja e jashtme dukej se ishte penduar, por sa vlen kjo. E dëgjova dhe avokatin e vrasësit, i cili kërkoi rrethana lehtësuese dhe arrest shtëpie, sepse gjoja ai po vinte vetë për t'u dorëzuar organeve të rendit. Por sa vlen kjo kur u shua një jetë në mes? Ky avokat vetëm i tillë nuk mund të quhet, përveçse një matrapaz. Shteti duhet të distancohet nga këta avokatë që përveçse zbusin ligjet, sjellin probleme sociale, ngaqë vrasësi nuk merr dënimin e duhur. Ndaj kam theksuar në titullin e shkrimit, ngjarja e Patosit apelon. U vra një djalë nga një adoleshent, por nuk do të thotë se nuk duhet dënuar, sepse shumica e vrasjeve janë bërë nga kjo kategori njerëzish.

Këto vite të tranzicionit është vërejtur një zbutje e madhe e ligjeve sidomos kur janë shuar jetë njerëzish, bile dhe brenda familjes, dhe rezultat, dënim i lehtë se paska qenë në krizë nervore, ose të tjera justifikime që "ustallarët" dinë t'i kurdisin mirë në raste të tilla. Në kohën kur qeveriste PD, në qytetin e Fierit u dënuan me varje vrasësit e Libofshës, sepse ekzistonte ligji e para vitit 1990, dhe për një kohë nuk pati krime. Por u gjend dhe vegja siç thotë populli. Shkelen të drejtat e njeriut dhe u hoq dënimi me vdekje që ekzistonin dhe sot, por që i ka sjellë dëme të mëdha këtij vendi, ku mijëra familje janë në hasmëri, sepse të pakënaqur me dënime, kanë zgjedhur rrugën kanunore. Nuk duket pak si e pakëndshme që bota na komandon pa na njohur në traditë dhe psikologji? Mos vallë duhet dënimin me vdekje për pak vite pas fillimit të sistemit demokratik? Shtete që e aplikojnë dënimin me vdekje si Kina, Irani, Pakistani dhe vendi më demokratik në botë Amerika, e kanë dhe sot e kësaj dite. Bile pas viteve 90 në Amerikë nga 34 dënime me vdekje 19 kanë qenë fëmijë të cilësuar si kriminelë. Kjo do të thotë, bëj si them unë dhe mos bëj si veprim unë. Në vendin tonë edhe pse nuk ekziston dënimin me vdekje, nuk u është dhënë dënimi maksimal atyre që kanë vrarë, gjë që ka bërë të pakënaqur palën tjetër dhe shpesh është kryer vetëgjyqësi. Kjo nuk përbën imazh të mirë për një shtet ligjor dhe demokratik që pretendojmë. Ndaj dhe më shqetëson ngjarja e Patosit, e cila apelon çdo familjar, shoqërinë, shtetin, drejtësinë, shkollën gjithë të zgjedhurit që të merren më shumë me edukimin atdhetar të fëmijëve dhe brezit më të brishtë në tërësi, ku të gjithë së bashku të demostrojmë vlerat më të mira të popullit tonë, frymën e tolerancës, bashkëpunimit me njëri-tjetrin, ndaj shokut, shoqes, të sillemi para njëri-tjetrit si vëllezër, sepse jeta nuk është si telenovelë dashurie, por për të jetuar. Ngjarja në fjalë i apelon dhe ligjit të jetë rigoroz për të çuar në vend autoritetin e tij.

Nezir Vrapit



K. Azizolli, i shtati në rreshtin e parë.

disa ditësh ka pësuar një aksident. Shokët dhe shoqet e klasës kanë mbledhur një kontribut bamirësie për t'i ardhur në ndihmë vëllait të tyre. Kjo klasë ndoshta është nga të paktat e të rrallat që u drejtua bashkëmoshatarëve të Oklahomës në ditët e ciklonit të Sunamit me një letër që i drejtohej Presidentit të SHBA, ku shprehin dhimbjen dhe keqardhjen për fatkeqësitë që ju solli kjo dukuri e natyrës.

Në letërkthimin Presidentit i

falënderoi këta fëmijë që u erdhën pranë me zemër, ndaj, ai u thotë: "Prania juaj morale ka vlera njerëzore, ju lumtë!".

"Kjo klasë ka arritur vlera, - thotë drejtori z. Rauf Tabaku, sepse ecuria dhe vijueshmëria janë model në shkollë, pa lënë në harrës veprimtaritë e tjera të larmishme.

Me këtë rast duhet theksuar vlerat që ka dhe merr triptiku prind-mësues-nxënës, kur ky është i barazvlerëshëm me vlerësimin: "Jeta pasqyron të vërtetën dhe koha, shoqëria bënë

SHKURT

Fondi i tokës shpërdorohet

Askush nuk po e kupton se fondi i tokës bujqësore pak nga pak po shpërdorohet. Të gjithë e kemi vënë re se nga dita në ditë ndërtime pa fund kanë zaptuar fushat në të dyja anët e rrugës kombëtare, ku persona të ndryshëm ndërtojnë shtëpi ose qendra biznesi. Pas viteve 90-të toka bujqësore po përdoret si mall pa zot. Fermerët të ndryshëm, afër qendrave urbane, por dhe në zonat rurale, kanë shtuar ose kanë vënë në shitje tokën bujqësore, sipas çmimeve që palët kanë rënë dakort. Në këtë tokë sot jeton mbi 50% e popullsisë në fshat. Dhe pse ndërtime vazhdojnë, vërehet një idiferentizëm i theksuar nga shteti, i cili duhet t'u thotë ndal ndërtimeve pa kriter në këto toka. Periudha e tranzicionit në vendin tonë bëri të mundur që shumë qytetarë të largohen në emigracion, por kjo nuk do të thotë se emigrimi do të jetë i përgjeshëm. Toka mbetet bazo për të jetuar dhe siguruar të ardhurat për çdo qytetar, sidomos për ata që jetojnë në fshat.

Që nesër të mos jetë vonë

Pas viteve '90-të, krahas shkatërrimeve që iu bënë vendit, këtë fat të keq e pësuan dhe kanalet kulluese të fushave, hidrovolet, stacionet e pompimit, aq të domosdoshme në rast të vërshimeve të lumenjve. Edhe para viteve '90 ka patur vërshime të lumenjve, por ka patur një regjim të rreptë përsa i përket masave ruajtëse të argjenturave dhe sidomos kanaleve kulluese për të përballuar këto vërshime. Shirat e kohëve të fundit shkaktojnë dëme të mëdha në disa rrethe ku pa gjë nuk doli dhe qyteti ynë. Po të shikosh të gjitha fushat në të gjitha fshatrat do të vëshes se nuk ka asnjë kanal kullues që të jetë në gatishmëri, për të përballuar shirat e shumta dhe vërshimet e mundshme të lumenjve dhe përrënjeve që na rrethojnë. Sa herë që bien shirat dhe vërshojnë lumenjtë, te ne përdoret një praktikë e keqe, fillohet marrja e masave, bëhen sikur pastrohen kanale, zihenn pritrat, sikundër ndodhi me pastrimin e një pjesë të lumit Osam përballë lagjes Goricë para pak kohësh. Që nesër të mos jetë vonë dhe të mos shkaktohen dëme në popull dhe në fusha, duhen marrë masa që më parë dhe jo kur vjen veza të kërkosh furrikun. Çatia riparohet në kohë të mirë.

Frikë, apo zbatim i rregullores

Kushdo që hipën në furgon për të udhëtuar, do të ndeshet me një sërë shkeljeshe të rregullores së qarkullimit rrugor. Drejtuesit e mjeteve garojnë me njëri-tjetrin kush mund të marrë me tepër pasagjerë duke harruar se në mjetin e tij ka pasagjerë. Shpejtësia tej normave të lejuara, shpesh, ka sjellë aksidente me pasoja për qytetarët dhe vetë drejtuesit. Ata kujtohen se kanë shkelje në drejtimin e mjetit vetëm kur shikojnë postoblokun e policisë dhe fillojnë të zbusin shpejtësinë dhe ndërkojnë të venë me të shpejtë rripin e sigurimit. Si mund t'i shpjegojmë këto veprime, frikë apo zbatim të rregullores?

Zotërinj të drejtimit të mjeteve, polici vetëm sa kontrollon zbatimin e shkeljes së rregullores, por ajo është detyrë për ta zbatuar nga ana juaj. Policia duhet të jetë më e rreptë ndaj shkelësve të rregullores.

Mjedis i pakëndshëm në poliklinikë

Bëhet fjalë për poliklinikën e Beratit. Po të hysh në mjediset e saj, do të shikosh mure të plasuritur, zhgaravitje. Në katin e dytë dyert e banjove jo vetëm që nuk funksionojnë por qëndrojnë të hequra dhe të mbështetura pas murit duke kërkuar që dikush t'i kthejë në identitet. Ky institucion shëndetësor kërkon që dikush të investojë për rikonstrukcion. Reparti i radiologjisë lë për të dëshiruar, një mjedis i vjetër që i ngjan një gërmalle.

— | Foto: | —

"MANGALEMI"

Vëllezërit Nasi & Mika

KAFE "MIAMI"

"Çelepias" pranë 6 katëshit...

Tel. 069

2151722

*Shitet një shtëpi dykatëshe në lagjen
"Muzakaj" e përbërë:*

*2 hyrje, 7 dhoma, 2 mjedise gatimi, 3 banjo,
ballkon, verandë, oborr, parking,
kopësht me pemë.*

Tel: 032 32 638

"ALUSH QERESHNIKU"

Në dyqanin tonë do të gjeni:
80 lloje verërash. Të gjitha
verërat e Beratit.

PAISJE HIDROSANITARE

Dyqani i S hpatës

Adresa: AXHENSIA

TEL: 068 27 03 384 (ILIA)

Artikuj shkollorë zyre

fotokopje, shtypshkrime, plastifikuese,
punë kompjuteri.

INTERSIG.

Adresa: Ngjitur me postën qendrore

FERDINAND KADIFEJA

Tel: 32 246

Shumica

— Ushqimore —

Tek Axhensia

Rexhep Arza

Okazion

*Shiten makina qepse për lëkurë dhe
këpucë, shitet lëkurë dhe copa lëkure.*


Shiten paisje të ndryshme.

: 069 22 082 72

Steku

Ndërtime

: 069 20 96 191



Syri i
Lajmëtarit

PROBLEMI I TË PASTREHËVE ZGJIDHET PAS 75-VJETËSH

1220 ndërtime pa
leje në ankth për
legalizimin

1510 të pastrehë në
pritje të një shtëpie
të re

204 familje në
listen e
emergjencës

Qyteti-muze i Beratit me 64 mijë banorë numëron 1220 familje që kanë ndërthurur shtëpitë e tyre pa leje në të gjitha pjesët e qytetit dhe 1510 familje të pastreha që presin me shpresa tashmë të shuara një shtëpi të re. Jo vetëm të pastrehët janë në ankth për shkak të pritjes së një shtëpie të re, por edhe ata që kanë ndërthurur një të tillë, janë në "ethe". Levizjet demografike të filluara në vitin 1991, të cilat kanë vazhduar pa ndërpreje deri në ditët e sotme, kanë sjellë 1220 shtëpi të reja, të cilat janë të palegalizuara. Këto ndërtime përfshijnë thauja të gjithë zonën urbane të qytetit të Beratit duke filluar në lagjen Uznovë, vazhdojnë në zonën informale tek ish-pyrrorja, në pjesën perëndimore e lagjes Kala dhe në pjesën e ish-kombinatit, duke përfunduar në të gjitha pjesët e brendshme të qytetit-muze.

Në një prononcim për shtyp, kryetari i bashkisë, z.Fadil Nasufi, është shprehur se për zonat informale pritet ligji dhe më pas do të vepron rast pas rasti". Ndërsa për ndërtime pa leje në territoret e shkollave, të cilat kapin

shifrën 31, kryebashkiaku ka fajësuar policinë ndërtimore, pasi, sipas tij, është ajo që duhet të japë llogari për këtë problem.

Qyteti i Beratit me 64 mijë banorë numëron 1511 familje të pastreha që janë në pritje të një shtëpie të re. Të pastrehëve që ka patur bashkia e Beratit deri në vitin 1997, u janë shtuar edhe të tjera familje të cilat shtëpitë e tyre i humbën në firmat rentiere si dhe të tjera familje të reja të krijuara nga ndarja prej trunqut familjar. Kjo bën që numri i të pastrehëve sot në raport me popullsinë të jetë ndër më të lartat në shkallë vendi. Për shkak të papunësisë që ka përfshirë qytetin dhe varfërisë si produkt i kësaj papunësie, as që mendohet që ky numër të zbutet nga ndërtime apo blerjet e shtëpive nga vetë të pastrehët, ndaj që të gjithë presin që ky problem të zgjidhet nëpërmjet bashkisë së qytetit. Në zyrën e të pastrehëve në bashkinë e qytetit të Beratit, z. Klarita Shyti, pohon: "Ne nuk kemi një listë tashmë të saktë për numrin e të pastrehëve. Ne kemi një numër të vitit të

kaluar të të pastrehëve që është 1511. Në muajin nëntor të vitit 2004 ka hyrë në fuqi ligji 9232, dt. 13 maj 2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonës urbane", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Ne si bashki mbi bazën ligjore përkatëse jemi duke zbatuar procedurat dhe fazat me anë të të cilave do të arrihet regjistrimi dhe verifikimi i plotë i të gjitha nevojave për strehim në qytetin tonë. Nga regjistrimi i ri rezulton se deri tani kanë aplikuar për t'u trajtuar me shtëpi banimi 200 familje." Familjet e pastreha e kanë humbur shpresën se një ditë do të kenë një shtëpi të re nga ndertimet e bashkisë, ndaj edhe numri i aplikuesëve ka rënë ndjeshëm. Më tepër aplikojnë të pastrehët që nuk kanë as një të ardhur apo fëmijë në emigrim, por rrojnë vetëm me përkrahjen sociale. Na është kërkuar nga ministria përkatëse lista e emergjencës nga ku rezultojnë 204 familje dhe në qoftë se për vitin 2006 do të ndërtohet një pallat me 20 hyrje, nga numri total prej 1511 familje të pastreha do të

perfitojnë 20 familje". Pra siç edhe shihet po të ecet me këto ritme, problemi i strehimit në Berat zgjidhet pas 75 vjetësh. Nga numri total prej 1511 janë regjistruar 255 të pastrehë që u përkasin të përndjekurve politikë dhe janë trajtuar nga ky kontingjent 32 prej tyre, 132 familje të pastreha janë qiramarrëse në objektet e ish-pronarëve dhe prej këtyre kanë marrë shtëpi 48 familje, si dhe nga rënia e firmave rentiere janë gjithsej 38 familje dhe janë trajtuar 8 prej tyre. Për vitin 2005 janë ndarë 24 hyrje nga të cilat 8 hyrje u përkasin jetimëve dhe 10 familjeve që banonin në shtëpitë e ish-pronarëve, gjithashtu kanë përfutur hyrje për këtë vit edhe 4 familje me statusin e të pastrehut, një banesë u përket të përndjekurve politikë dhe një i përket një shtëpie, të cilit i është prishur banesa për shkak të planit rregullues të qytetit. "Ne si bashki do të paguajmë koston lokale të përqindjes së këtyre banesave që ka shpallur qeveria. Deri tani nuk është zbardhur asnjë zë për vitin 2006 në drejtim të ndërtimit të shtëpive për familjarët e regjistruar si të pastrehë" shprehet për


qytetin kryetari i bashkisë, z. Nasufi.

Abedin Kaja

E PLAGOS ME THIKË, PRANGA AUTORIT

Njoftime nga drejtorja e policisë Berat bëjnë të ditur se në datë 16.01.06, rreth orës 19:45, agjentë të policisë kriminale të postës së policisë Poliçan, kanë bërë arrestimin e shtetasit Adem Zenuni, vjeç 23 nga fshati Tozhan i komunës Terpan, Berat. Arrestimi i tij është bërë për arsye se disa ditë më parë shtetasi, pas një zënke me motive të dobëta me bashkëfshatarin e vet Çelik Naze, vjeç 29 e ka plagosur atë me thikë në kofshë. I dëmtuari ndodhet shtruar në spitalin e Beratit jashtë rrezikut për jetën. Pas arrestimit nga ana e policisë, agresorit Zenuni iu gjet edhe një thikë për të cilën pritet akti i ekspertimit nëse ajo i plotëson kushtet e armëmbajtjes pa leje si dhe akti mjeko-ligjor i plagosjes së shtetasit Naze. Po punohet për zbardhjen e ngjarjes, pohoet në njoftimin për shtyp të lëshuar nga drejtorja e policisë Berat.

E keni gabim, shkruajti "Lajmëtarit"!



Bisedoja me një shok. Ishte i shtetësuar, sepse shikonte ende në disa administrata shtetërore në Berat qëndrime burokratike, qëndrime tarafilëku, shfrytëzime interesash, e tjera, e tjera.

Të them të drejtën, nga që i kishte të argumentuara, më bindi, ndaj i them:

- Shkruaj këto në gazetën "Lajmëtarit"!

- Jo, jo! - ma ktheu.

- Përse? - i them.

- Jo se më mungon kurajoja për të shkruar hapur, por sepse ata të gazetës nuk kanë për ta botuar.

- Përse? - i them.

- Po unë dikur kam qenë komunist.

Qesha.

- Po më çudit, - ia ktheva. - E keni lexuar ndonjëherë gazetën "Lajmëtarit" ju?

- Po, - më tha.

- Atëherë si nuk të paskan rënë në sy sa e sa shkrime për njerëz që dikur kanë qenë komunistë, apo që janë komunistë, pasi ata janë vlerësuar nga kontributet që kanë dhënë e japin në shoqëri. Çuditë, - i them, - si nuk i paske parë edhe autorët e disa shkrimeve në "Lajmëtarit"? Ata kanë qenë dikur komunistë. Mos bëj gabim, - këmbëngula unë, - që të mos i shkruash gazetës dhe të nisësh nga mendimi i gabuar se paskeni qenë dikur komunist. Të jeni i sigurt, nëse ato që më folët mua do t'i shkruani qartë, keni për ta lexuar artikullin të hënën të "Lajmëtarit".

E binda.

- Do ta dërgoj, - më tha.

V. Lasho

Mësimdhënia profesion fisnik

A ka gjë më fisnike ose të nderuar se sa të ndryshosh jetën e një fëmije? Sigurisht që jo, sepse të bësh një fëmijë të paarritshëm e të lësh gjurmë në jetën e tij, themi se puna dhe sfida që ti ke synuar e ka arritur suksesin dhe ky sukses arrihet nëpërmjet mësimdhënies.

Mësimdhënia është art e shkencë e si e tillë ajo duhet përvetësuar e menaxhuar më së miri nga ana e mësuesit. Ky menaxhim duhet të ketë objektiva të qarta ku në qendër të mësimit është vetë nxënësi. Mësuesi vetëm rregullon dhe përshat mësimdhënien dhe objektivat e saj me interesat dhe nevojat e nxënësve. Një mësimdhënës i sukseshëm është dhe një udhëheqës efektiv, duke përdorur mundësinë e grupit për të zhvilluar rritjen individuale të çdo nxënësi. Në çdo kohë mësimdhënies vepron si një model në demonstrimin se si të mendojmë rreth problemeve. Çdo njeri nga ne duke folur për eksperiencën e tij flet për sekretet e suksesit të mësimdhënies në vite, e midis të tjerave ndiejmë krenarinë e të qenit mësimdhënës. Më poshtë po ndalem në disa nga sekretet e mësimdhënies për të qenë i suksesshëm.

-Mësuesi qysh në fillim të orës së mësimi duhet të bëjë një ecje të shpejtë në klasë, duke organizuar edhe një lojë të shpejtë me nxënësit.

-Duhet të përshëndetet e të buzëqeshë miqësisht e të mbështetë inkurajimin e nxënësve.

-T'u krijojë nxënësve mundësinë të përcaktojnë e të shkruajnë vetë rreth të nxëniti. Më pas t'i shikojë dhe t'i korigjojë ato duke i lënë nxënësit të vlerësojnë vetë të nxëniti e tyre.

Mësimdhënies duhet të respektojë diversitetin e mendimeve të tyre, t'i kanalizojë nxënësit të ndjekin linjën e pyetjeve: "Pse", "Çfarë", "Si" dhe "Çfarë nëqoftëse".

-Duke bërë këto ai duhet të vendosë objektiva të qarta specifike, pozitive e realiste.

-Duhet të vlerësojë fuqishëm edhe mjedisin e klasës duke krijuar atmosferë jetësore.

-Gjatë mësimdhënies duhet të reduktojë mesazhet e paqarta duke përdorur hartat e mendimit se çfarë kanë mësuar nga të nxëniti e të lejojë nxënësit të bisedojnë me njëri-tjetrin për të shtuar informacionin që duan.

-Vendosja e posterave afirmuese, vizatimeve në mure inkurajon të nxëniti e shpesh duhet të përdorim shprehjen "së bashku ne arrijmë suksese".

-Shtimi i përditshëm i informacionit nga ana e mësuesit mban vëmendje shumë të përqendruar dhe rrit të kuptuarit e kujtesës.

Mësimdhënies duhet të ketë parasysh që nxënësi ka nevojë dhe për pushime, sepse truri vepron me cikle e për këtë ai duhet të alternojë lëndën me njera-tjetrën.

-Sukses tjetër pozitiv është dhe rifreskimi i tabelave të ndryshme.

Mësimdhënies duhet të rrisin sa më shumë numrin e konkluzioneve dhe analizave duke bërë vlerësime, diskutime në grup, analiza në grup, konkurse e lojra të ndryshme.

-Duhet të kemi besimin të nxënësit dhe ky besim arrihet nëpërmjet përsëritjes.

-Në çdo mbyllje të orës së mësimi duhet të përfshihen edhe vetë nxënësit duke përdorur shpesh edhe shprehjen: "Ajo çka mësuam sot ishte me të vërtetë shumë e rëndësishme", ose për sot "kaq është e mjaftueshme për momentin".

-Rituali i mbylljes evokon emocione pozitive, të cilat ndihmojnë në përvetësimin e mësimi duke u bërë zbatimës e për ta mbahet gjatë në kujtesë.

E pra këto ishin disa prej sekretëve të Profesionit më fisnik e më të nderuar të mësimdhënies, ku nëpërmjet saj ne edukojmë fëmijë të vlefshëm për vetveten dhe shoqërinë, qytetare të denjë të së ardhmes.

Mes dekadencës dhe virtytit: Interpretime të njohura të historisë në Rusinë e Putinit

Dmitry Shlapentokh

Dmitry Shlapentokh është Profesor në Departamentin e Historisë, në Universitetin e Indianës, South Bend. Ai shkruan shpesh rreth historisë moderne ruse, si dhe politikës dhe kulturës.

Krijimi i një vizioni të caktuar për të kaluarën ka qenë gjithmonë i rëndësishëm në formimin e idologjive të regjimeve ruse. Regjisori dhe televizionet në Rusinë së sotme mund të mësojnë shumë gjëra nga mendimet zyrtare apo gjysmëzyrtare të historisë ruse nën regjimet e mëparshme. Dhe, sigurisht, që televizioni është ai që formon qendrimet popullore sot në Rusi, siç ndodh edhe në shumë shoqëri të tjera të industrializuara.


Ngritja e televizionit si mjet popullor komunikimi shënon një ndryshim të rëndësishëm në zakonet shoqërore që nga koha e sovjetikëve. Televizioni sovjetik ishte shumë i mërziqshëm, tejet i politizuar dhe praktikisht i pandjekshëm. Shtypi i shkruar mund të konkuronte lehtë me median vizuale për të fituar vëmendjen e publikut sovjetik. (Rusët mund të krenoheshin se ishin lexuesit më të etur me vendeve bashkëkohore.) Por nga fillimi i epokës së Jeltsinit leximi, dhe veçanërisht leximi i literaturës politike, ra dukshëm dhe televizioni filloi të zinte vend tek rusët. Ata që kontrollonin televizionin gjatë periudhës së Jeltsinit, pjesa më e madhe qeveritarë, mund ta lëkundnin opinionin publik si të donin. Në përgjithësi, besohet se televizioni i siguroi Jeltsinit fitoren në vitin 1996 dhe ngritjen e Putinit në pushtet në vitin 2000. Putini e kuptonte rolin e televizionit dhe dëshira e tij për të siguruar kontrollin e shtetit mbi median ishte një nga arsyt kryesore që shtynë dy bosët e medias së epokës së Jeltsinit, Vladimir Gusinski dhe Boris Berzovski, të largoheshin nga vendi. Sot, televizionet (dhe praktikisht këtu përfshihen të gjitha), e kontrolluara nga shteti kanë një nivel të lartë censure. Kjo ndodh veçanërisht me lajmet që kanë të bëjnë me vetë Putinin. (Pavarësisht se ka kritika të rralla të presidentit në shtyp, veçanërisht në publikimet më pak të njohura, në televizion nuk shihet një gjë e tillë.) Prandaj, versioni i historisë i paraqitur në televizionin rus merr një status zyrtar apo të paktën gjysmëzyrtar.

Egziston prirja për të krahasuar propagandën e "bolshëvizmit kombëtar" të Stalinit me trajtimin e historisë nga media e Putinit. Edhe Putini edhe Stalini ishin të dy sundues që i dhanë fund një periudhe revolucionare (njëri 1917-1921 dhe tjetri 1985-2000), po të dy u përpoqën të krijojnë një ideologji pasrevolucionare duke përzier elemente të vjetra dhe të reja. Megjithatë, për Stalinit, e kaluara paraqiste një problem serioz: arritjet e kohëve të mëparshme nuk mund të injoroheshin. Stalini iu kthye së kaluarës për të kërkuar individë që ishin sundues të fuqishëm dhe shpeshjet morale, si Ivar Ljungrin dhe Pjetri i Madh. Sipas Putinit, e kaluara e të përhapur nga propagandë dhe heqësit e

mëparshëm rus kishin dështuar jo ngaqë kishin shkelur Dhjetë Urdhëresat, por sepse nuk kishin arritur të përmbushnin detyrën kryesore, të mundnin armiqtë e Rusisë. Nga ana tjetër, Putini kërkon të kaluarën për shembuj nacionalizmi fetar dhe ngjarje që tregojnë se përkushtimi ndaj kombit rus dhe kristianizmit ortodoks është më i rëndësishëm se fitorja. Ndërsa për Stalinit periudha sovjetike ishte kulmi i historisë ruse, për Putinin ajo ishte thjeshtë devijim. Stalini theksonte fuqinë perandorake të Bashkimit Sovjetik, ndërsa propaganda e Putinit duket se përhap një formë nacionalizmi famullitar dhe vetëqendrore që i ka rrënjët në pasigurinë kolektive.

E ngjashme me makinën propagandistike të Stalinit, televizioni i Putinit i kushton shumë vëmendje ngjarjeve të kaluara që tregojnë shpirtin patriotik të popullit rus. Gjatë 625-vjetorit të Betejës së Kulikovës në vitin 1380, ku forcat ruse mposhtën për herë të parë ushtrinë mongole, një komentator televiziv ngriti lart jo vetëm patriotizmin e popullit rus, por edhe rolin e kishës ortodokse. Ai sugjeroi se pa bekimin e kishës nuk do të kishte fitore dhe deklaroi se kjo betejë i kishte mbledhur përfundimisht rusët në një komb. I njëjtë përqëndrim në bashkimin patriotik dhe nacionalizmin ortodoks vihet re edhe në trajtimin e ngjarjeve më të fundit. Gjatë 100-vjetorit të luftës Ruso-Japoneze 1904-1905, një dokumentar televiziv pasqyrore betejën e marinës ku anija luftarake ruse Variag (e ndërtuar në Filadelfia), u fundos nga armata japoneze. Japonezët e kishin rrethuar Variagun me forca shumë më të mëdha. Ata nuk prisnin që rusët të luftonin dhe ishin gati të pranonin dorëzimin e tyre. Por sipas filmit, edhe marinaret rusë, përfaqësues të klasave të ulëta, edhe oficerët, ishin pajtuar njëzëri se dorëzimi i tyre do të çnderonte Rusinë. Për çudinë e japonezëve, Variagu filloi luftën me guxim kundër flotës japoneze. Kjo betejë e pabarabartë u zhvillua para syve të anijeve nga vende të ndryshme të mbledhur para portit korean, në mënyrë që e gjithë bota të mund të admironte heroizmin rus. Dokumentari vë në dukje se kthimi i marinaretë të mbijetuar në Rusi u shoqërua nga një ekzistencë patriotizmi dhe demonstrime bashkimi me qeverisë, carit dhe popullit. Domethënës është fakti se filmi nuk përmend fare revolucionin e vitit 1905, i cili do të shkatërronte sensin e harmonisë perfekte mes popullit rus dhe sunduesve të tij. Megjithatë, aty u përmend beteja e Tsusimës, në të cilën japonezët shkatërruan flotën ruse. Në Japoni kjo ngjarje solli kultin e gjeneralit fitimtar Hideki Tojo, i cili u bë më vonë kryeministër i Japonisë dhe sundoi gjatë pjesës më të madhe të Luftës së dytë Botërore. Kjo temë u paraqit me sa duket për të theksuar se japonezët janë një popull patriotik që nderojnë heronjtë dhe perënditë e tyre, po aq patriotë sa rusët gjatë epokës së pararevolucionit.

Dokumentari tregonte gjithashtu një emigrant rus dhe koleksionist sendesh që kishin lidhje me Variagun. Ai dhe gazetari që kishte përgatitur kronikën filmike vënë në dukje se të gjitha problemet që kishin përfshirë Rusinë pas Revolucionit, ishin shkaktuar nga braktisja e fesë ortodokse. Sipas tyre, ortodoksia duhet të bëhej përsëri shtylla kryesore e Rusisë për ta bërë vendin përsëri po aq të lavdishëm sa ç'ka qenë në të kaluarën. Vizioni i idealizuar i Rusisë së pararevolucionit ka një ngjashmëri të



habitshme me vizionin e idealizuar të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS) në filmat e periudhës sovjetike, veçanërisht gjatë dekadës së Brezhnev, se në Bashkimin Sovjetik të propagandës së Stalinit kishte ende armiq që duhet të luftoheshin pa mëshirë.

Tregimet historike të periudhës sovjetike dhe kohës së Putinit shfaqin edhe dinamika historike krejtësisht të ndryshme. Në periudhën sovjetike historia kishte përparim të qëndrueshëm. Në Rusinë e Putinit tranzicioni nga Rusia perandorake në Bashkimin Sovjetik paraqitet si degjenerim i vërtetë. Kjo është ndryshe nga mënyra se si paraqitet historia sovjetike menjëherë pas rënies së komunizmit. Gjatë politikës së hapjes (glasnost) të Gorbaçovit dhe gjatë pjesës më të madhe të kohës së Jeltsinit, revolucioni komunist dhe ngjarjet që pasuan interpretoheshin si produkt i arrogancës marksiste intelektuale i bashkuar me devotshmërinë fillestare ruse dhe urinë e bolshevikëve për pushtet. Në versionin e Putinit, roli i ideologjisë në ngritjen artificiale të revolucionit lihet pas dore, ndërsa fokusi është tek paratë, korrupsioni dhe ambicjet personale. Për shembull, një historian rus vuri në dukje në një intervistë të kohëve të fundit se Putini dhe Revolucionin Bolshevik nuk mund të ndodhnin pa paratë e gjermanëve. Sipas analistëve të televizionit rus, regjimi sovjetik ishte një përzierje utopie dhe korrupsioni pa kufi. Një historian deklaroi në televizion se Lenini kishte idenë e revolucionit botëror dhe grabiti vendin për të financuar idetë e tij.

Sipas disa komentatorëve televizivë, korrupsioni është shfaqur që në ditët e para të regjimit komunist. Është nënkuptuar se Lenini toleronte korrupsionin dhe e shihte atë si pjesë

normale të jetës. Që nga revolucioni e më pas, bolshevikët nuk ishin asgjë tjetër, por të korruptuar që ndiqnin interesat e tyre materiale. Më vonë gjërat u bënë edhe më keq: burokracia sovjetike e viteve 1920 u përfshi në mashtrime, pastrim parash dhe të gjitha llojet e veseve, siç duket me bekimin e Leninit. Stalini ishte po aq i korruptuar dhe nën sundimin e tij korrupsioni u bë ai që mbante gjallë regjimin, i cili ishte ndërtuar në mënyrë të tillë që t'i sigurote burokracisë një jetë të mirë në kurriz të popullit.

Prandaj, në diskutimet popullore për periudhën sovjetike motivi kryesor është "ndotja" morale e shoqërisë nga të korruptuarit dhe burokracia parazitë. Për ta mbështetur këtë, komentatorët shpesh përdorin shembuj nga më të çuditshmit. Thuhej, për shembull, se rrogat e vogla të modeleve ruse të modës në kohën e Brezhnevit i kishin detyruar shumë prej tyre të merreshin me prostitucion (nganjëherë me inkurajimin e KGB-së). Nuk është çudi që regjimi sovjetik duhej të rrezohet dhe t'i hapte rrugën një shoqërie passovjetike të shëndetshme, pa korrupsion, fetare dhe patriotike.

Mund të debatohet se tregimet historike popullore në Rusinë e Putinit pasqyrojnë shqetësimet e regjimit: stabilitetin, ruajtjen e identitetit dhe status quo-në. Prandaj ka ndodhur përqëndrimi tek besimi fetar dhe bashkimi shoqëror, flakja e korrupsionit dhe dekadencës në rolin e së keqes dominante historike. Ka edhe një hezitim të qartë për t'u angazhuar në një diskutim të ndershëm për Revolucionin Bolshevik dhe revolucionin antikomunist në vitin 1990, sikur regjimi të kishte frikë se ngjarjet që tronditën Rusinë në fillim dhe në fund të shekullit të 20-të mund të përsëriten në të ardhmen. Kjo frikë shpjegon edhe zëvendësimin kohë e fundit të festës së 7 Nëntorit, përvjetori i Revolucionit Bolshevik, me një festë të re, Ditën e Bashkimit Rus, e cila përkujton dëbimin e polakëve në shekullin e shtatëmbëdhjetë nga Moska. Ajo

Varri i Paranomit

Një mëngjes, në një nga kafenetë e Breg Lumit, së bashku me Jorgji Bendin hymë në bisedë rreth historisë së pashkruar të qytetit tonë.

Jorgji i erdh ndër mend historia e një varri të vjetër, rreth 250-vjeçar, që njihet ende sot me emrin Varri i Paranomit. Këtë histori në familjen e tij e kishin dëgjuar nga i gjyshi, që mbante të njëjtin emër me të.

Ky varr gjendet në një shesh të vogël rreth 50 metra nën Sheshin e Dosave. Gjurmët e tij nuk shihen, por emri në atë shesh i ka mbetur. Këtu, të ky shesh, Jorgji me moshatarët e tij mbledheshin dhe luani lodra fëmijësh që për kohën qeheshin të ndaluara, se nxisnin vesin e kumarit, për t'u fshehur syrit të mësuesve dhe të prindërve.

E ndërtaam gur-gur historinë paksa të çuditshme të këtij varri, që ngrihet në një vend larg sinorit të kishës, gjë e rrallë për kohën, i mbetur ndër vite si një varr jetim, por që nuk u harrua.

Ishte një burrë nga lagjia e Goricës, që njihet me emrin Pandi. Thirrje edhe Pando. Ishte një bejtexhi i njohur, shumë i zgjuar. Aty për aty ta ngjiste bejten, ta kurdishte një paranom. Prandaj edhe filluan ta quanin Pand Paranomi. Meqë edhe emri i tij kishte një farë ngjashmërie, kjo noftë i mbeti jo vetëm sa që gjallë, por edhe pas vdekjes.

Nuk linte njeri pa një paranom. I merrte goricarët, por edhe zanatçinjtë e tjerë të njohur dhe të panjohur, me radhë. Dhe nuk i zemëroheshin me përjashtim të atyre rasteve kur u vinte në dukje ndonjë xanaxë ose të metë që nuk duhej ta dinin të tjerët. Më tepër vinte në shenjë, kopracinën, dembelizmin, thashethemet, sjelljen e ndonjë çapëni...

Kur ndonjë goricarkë e bukur kalonte para dyqanit të ndonjërit dhe ky linte punën dhe i ulur në bisht e ndiqte me lakmi, Pandi, sa e shihte ose e kuptonte djallëzinë e tij, i hynte në dyqan dhe i thoshte:

- Këtë herë më duket e paske radhën ti.

- Aman, Pando, se më fute në sherr me gruan.

- Kur e paske kaq frikë, pse nuk shikon punën tënde dhe pse nuk ngjëllet në çairin tënd, po na kërkon të kullotësh gjatë?

Opinion për një traditë të Beratit

Përtej nostalgjisë së një festivali...

Në çdo verë e vjeshtë prej shumë vitesh shtëpia e Poliksenit e Eleni Goxhomanit në lagjen Mangalem ishte kthyer në një "seli" të Festivalit të Likove të qytetit. Po ta pyesje nënë Poliksenin se ç'moshë kishte ky festival, ajo ndjehej disi fajtoze se nuk e mbante mend e nuk ishte asnjëherë e saktë. Nuk e mbante mend kur kishte nisur kjo ceremoni në shtëpinë e tyre, në këtë qytet. Nënë Polikseni jetoi gjatë, mbi 90 vjeç duke bërë një jetë të tërë liko të shumëllojshme. Edhe ajo i kishte pyetur dikur plakun e lagjes, gjyshet, por të gjitha kishin ngritur supet pajafjesisht për moshën e këtij festivali. Vitet ishin bërë si gurët e lëmuar të Mangalemit, të Goricës, Kalasë që dukeshin sikur përkëdheshin nga këmbët e fëmijëve që dilnin më shpejt se duhej në rrugicat ku hidhnin krahet e bleritë hardhitë, lulet e shumta, portokallet. Vitet ishin bërë si hapat e vajzave-nuse që një ditë shkonin drejt pragjeve të reja, apo si plakun e pastra që, me ca pantofla të buta, uleshin ca çaste në gurët e mëdhenj të portave të tyre duke folur për bëmat e qytetit, të burrave të tyre...

Në të vërtetë përgatitjet për këtë festival kishin filluar që në pranverë. Kishin nisur larg, në Tomor, në Shpiragun vija-vija. Në Dumre e Mallakastër. Në nahijen e Skraparit e në Roshnik... Në tregun e qytetit apo edhe në portat

I zëni në faj dyqanxhiu, rrinte me ditë të tëra me gjak të ngjirë. Por Pandoja bënte sikur kishte harruar dhe i ngjiste ndonjë paranom tjetër të pranueshëm për të.

I ndryshonte njerëzit që vinte në shenjë çdo dy javë, se, thoshte, vetëm kështu ata do ta ndienin peshën e paranomit që u ngjiste.

Ata që e takonin, e prisnin me shqetësim me ç'bejta sa t'i përcillte. Se ajo edhe mund t'u mbetej jo vetëm dy javë, por edhe gjithë jetën siç kishte ndodhur në ndonjë rast.

Në ditët e ngrohta, çdo mëngjes merrte të përpjetën e malit dhe ulej në sheshin e vogël nën Sheshin e Dosave nga vështronte lindjen e diellit dhe bukuritë e qytetit. Shihte njerëzit kur hidheshin mbi urën me themele guri dhe harqe prej druri, shihte dyqantë në bregun e përtejme, djemtë kur laheshin... Dhe që atje çdo gjë i dukej e bukur, pa ndonjë të metë, se ashtu ia kërkonte zemra t'i shihte qytetin dhe bashkëqytetarët e tij. Si i ngopej shpirti, merrte të tatëpjetën për t'u kthyer pranë jetës së përditshme...

Qëllonte që e shihte ndonjë plakë dhe e qëndronte për të këmbëruar ndonjë fjalë:

- Ruhu, Pando, se mos të ha ndonjë derr i egër dhe s'kemi si të të ngjallim së vdekuri.

- Mos ma ki frikën, moj ato. Nuk vijnë dërrat në atë shesh ku rri unë. Edhe ata ruhen prej meje si burrat tuaj. Ma kanë frikën se mos u ngjis ndonjë paranom.

Dhe të dy ndaheshin duke qeshur.

Kur iu afrua vdekja, u la amanet goricarëve që ta varrosnin në sheshin ku qëndronte shpesh në vetmi për të soditur Beratit. Dëshia ta kishte qytetin gjithmonë para syve.

Ishte i zgjuar Pandi. Ai deshi të mbetej në kujtesën e goricarëve dhe të beratasve i paharruar. Dhe kështu mbeti.

Kaluan vite e vite. Shumë njerëz ikën dhe të tjerë erdhën. Dhe këta si të parët ikën. Shumica u harruan. Mbeti vetëm Varri i Paranomit. Bashkë me të edhe kjo histori që lidhet me emrin e atij që prehet në atë vend të bukur mbi lagjen Goricë dhe përballë qytetit, të cilën e solli rasti ta kujtojme dhe ta ringrejme sot mbas kaq e kaq vitesh.

Agim Mehqemeja

merrnin ato qëndisima në duart e tyre! Se asnjë nuk duhej t'i ngjante tjetrës. Vetëm në një gjë duhet të bashkoheshin: të PASTËRTIA e BARDHËSIA. Duket se shtëpitë tradicionale të Beratit në të gjitha lagjet kishin bërë një krushq të përjetshme me pragjet, me qëndisimat e me shpirtin e tyre të bardhë. Ato qëndisnin dhe përfytyronin ditëdasmata e tyre ku të gjithë miqtë do të mburrnin likotë e nënave të Mangalemit.

Kishte nisur ky festival në të gjitha shtëpitë beratase që ishin kthyer në "shkolla" të vërteta ku gjyshet, nënat si "profesorët" më të repta, të sakta e të pakorrptueshme i jepnin traditën vajzave e dëshironin, pse jo, që ato t'ua kalonin një ditë.

E vjeshta beratase vinte e gjitha erë liko. Vinte erë mushti vere e rakie të zier. Dasmata kishin kohë që kishin filluar e ato padyshim donin likonë e urimit, verën e ëmbël e rakinë e fortë, me të cilën mburrshin kush e kush më shumë...

Në ditët e para të teorit, në shtëpinë e Poliksenit e të Eleni Goxhomanit vinin grana të gjitha lagjet e qytetit. Në dorë mbanin ca kupa qelqore të mbështjella me peceta të pastra. Njera prej tyre mbante mullirin e kafesë dhe kafe për ta pjekur që aty të piqej, të bluiej e të pihej duke përcjellë sa e sa urime për njëra-tjetrën. Nikoqiret e shtëpisë do të vinin vetëm sheqerin e filxhanët. Jo se s'kishin, por ky rregull sikur i miqësonte më tepër gratë. Nga kurora e ullinjve nisnin të vileshtin koshat e parë e vaji i tyre e bënte më të shijshëm gjellën. Ftonjtë ishin zverdhur në degë e prisnin duart e nënave që t'i këpusnin e të bënin likonë e ëmbël apo t'i futnin në sepete për t'i ngrënë në dimrin e gjatë. Zahireja që kishte mbushur shtëpitë tani mund të prekej e të gatuhet. Të çuditshme koto gra të qytetit të lashtë! Jo thjesht për moshën mbi 60 vjeç, por edhe për duart e dy grave duararta. Poliksenit e Elenit, që më të rejat ia puthnin duart. Vjeshta beratase e mali i Tomorit që i përshëndeste nga dritarja e hapur, sikur bëheshin më të vegjël para këtij ceremoniali. Kështu likotë e kajsisë, të thanës, të fikut, të portokallit, të ftoit, të trëndafilut, të thanës, të domateve e të patërhanit, viheshin në pjata të vogla e kalonin sa në një dorë në tjetër për t'i provuar të gjitha nga pak.

E do të mbaronte ky festival më 26 tetor që quhej dita e Shën Mitrit. Borë e furtunë. Shi apo diell. Përfaqësueset e lagjeve do të caktonin fituesin. Asnjë certifikatë për të! Asnjë medalje! Asnjë diplomë! Asnjë gazetar, kronikan nuk e ndiqte këtë festival! Asnjë...! Dëshmitar ishte Mangalemi që ishte më i moshuar nga të gjitha anëtarët e mundshëm të jurisë. Po të nesërmen i gjithë qyteti e merrte vesh se kush fitoi. Fituesja merrte urimet e të gjithave. "Të lumshin duart e paç vetëm lajme të ëmbla në jetë! Ju ëmbëlsoftë pragu i shtëpisë! Ta hëngërshim në dasmata e fëmijëve e nipërve!" Ndërkohë kjo fituese duhet të përgatitje edhe për të ndarë liko për familjet që e kishin më afër gëzimin. Nga gëzimi dikush ia merrte një këngë të re të krijuar aty për aty. Ishte kurora më e bukur që mund të merrje e të jepje në këtë festival. Nga më të bukurit! Nga më tradicionalet! Nga më masivët!

Një festival që i hapte udhë urimeve për shtëpitë e reja, për pagëzimet e vënien e

emrave, për lindjet e dasmata, për nisjen e djemve ushtarë e për nisjen e kurbetçinjve. Për Bajramet e Krishtlindjet. Për pemët e mbjella e për miqësitë e reja...

E sotmja qëndron përtej nostalgjisë së këtij festivali. Berati, si dhe Shqipëria hapi portat për Botën e madhe. Për shumë arsye gratë e "braktisën" festivalin, por jo traditën. Këtej e tutje likotë nuk shrohen vetëm në tavolinat beratase, por edhe në Athinë, Selanik, Itali, Kanada, Amerikë, Spanjë. Kudo ku ka beratas të emigruar.

Një amvisë më tha këto ditë: "Peshon vazua e nuk e marrin dot se të gjithë duan të kenë sa më shumë me vete, por edhe për miqtë e huaj. Mbese doganierët shumëgjuhësh të të gjithë kontinenteve nuk mund ta kuptojnë "emigrimin" e kësaj ëmbëlsire karakteristike të vënë në disa vazo qelqore. Jo më pak ajo ka befasur edhe të huajt, diplomaetë, politikanët që vinë këtu. Mësues Petraq Goxhomanit na tregon për vizitën e kryetarit të bashkisë së Ulqinit në shtëpinë e tij, që u mrekullua nga surpriza e likosë beratase. Ende edhe sot dëgjon shprehjen: "Eja të hamë një liko të ëmbël e të pimë një gotë ujë të ftohtë të shtëpia ime!" Kur donim të takonim një nënë që e trashëgon akoma traditën e likove, të gjithë njëzëri na thanë të shkruanim për nënë Margalina Goxhomanin në lagjen Mangalem. Shlloje e saj është një "Muze" i vërtetë me disa lloje likoshe dhe kërkesat e shumë familjeve për likotë e dorës së saj rriten. Ngul këmbë që para se të shkruhet për likotë, ato duhet të provohen. Madje na jep edhe një vazo për kënaqësinë, për përtëritjen e festivalit të likove në Berat.

- Jam 64 vjeç dhe punën me likonë e kam nisur që në moshën 6 vjeç kur ndihmoja nënën dhe dëgjoja "profesore" Poliksenin. Më vjen keq që tradita po humb pak. Tani njerëzit janë bërë dembelë. Kanë dalë ca lloje çokollatash që futen në xhep e nuk merret vesh urimi. Ah, ç'grua ishte Polikseni! Një grua e kulturuar. Vinte nga Amerika dhe ishte halla e regjisorit Serafin Fanku. Një qime nuk i rrinte në trup. Unë respektoj edhe likotë e Përmetit, po edhe të fshatit të nënës sime, Pafalait.


Likojat e saj ka filluar të njihet në mjaft qytete, si në Elbasan, Tiranë, Margalina i gëzohet përtëritjes së traditës së gjellëve të Beratit, po thotë se në lokalet karakteristike të qytetit fare mirë në rastin e miqve të largët, të huaj apo të rinj është mirë që si fillim të qerasen me liko. Miku i ri miran mend gjithmonë fjalën e parë e mënyrën se si e pret. Një enciklopedi e ëmbëlsirave beratase është kjo grua. Ajo i gëzohet edhe përcjelljes së traditës tek mbesa 12-vjeçare që sa herë vjen nga kurbeti, mëson nga gjyshja teknikën e likove...

Megjithatë ende duhet bërë. Kur kjo traditë ekziston ende në familjet tradicionale, do të ishte mirë që në konkurset e ndryshme me rastin e binjakëzimeve me qytete të huaj, në Ditët e Trashëgimisë Kulturore, në vizitat e delegacioneve të shumtë bvendorë jashtë vendit apo në festa popullore ku promovohen vlerat etnografike tradicionale, ajo të zinte vendin e saj të merituar.

*


Përtej nostalgjisë së festivalit qëndron urimi njerëzor. I njëjtë për të gjithë kohërat. Besoj se pas këtij urimi vjen mbarësia e përjetshme për këtë qytet që ka harruar moshën e tij të lashtë, po jo traditën e mbijetuar në breg. Është një traditë që jo vetëm të fisnikëron, por dhe të rrit detyrimin për ta zgjuar vullshëm. Shumë më tepër se në vitet e kaluara.

Namik Selmani




Rituali i pjekjes së kafesë (Pjekja, bluarja e servirja)
foto Namik Selmani

F a q j a s p o r t



Përgatiti faqen sportive
Vlash Pambuku

Lindita e Blerta



Lindita Malasi

Blerta Nallbani

FUTBOLL

Pyesin sportdashësit

Bisedoja me disa tifozë. Veç njërit, të gjithë ishin të "thekur" pas futbollit. Nuk donin ta dinin nëse në Berat ka apo s'ka ekupe volejbollit e basketbollit. Me sa duket, ishin nga ata që vite më parë nuk i kanë ndjekur ndeshjet në këndin sportiv të lojërave.

Një tifoz futbollit më pyet: "Përse nuk po shkruhet në gazetë për futbollin e "Tomorit" kur dihet se ai ka ngecur e nuk po ecën?"

-Është shkruar disa herë, -i them. -Janë bërë shkrime nga më të ndryshme kritike, fejtone, karrikatura. Por puna e futbollit është e ngjashme me kritikën që janë bërë për Urën e Goricës, për shtëpitë e rrugicat e Mangalemit e për disa të tjera që nuk po zgjidhen.

Pa nënvleftësuar shkrimet kritike në gazeta, duhet thënë se gazeta e ka bërë punën e vet dhe se për ta ndryshuar gjendjen nuk duhet të nënvlerësohet ndërhyrja e përgjithshme e opinionit qytetar pranë bashkisë, futboll - klubit "Tomori" dhe FSHF.

Pyet tifozin i lojërave me dorë: Po me volejbollin e basketbollin të harruar, si do të bëhet?

-Ky kapitull për volejbollin dhe basketbollin është mbyllur, -i them, -pasi më parë duhet të ngrihet në Berat qendrat sportive (polistere apo pallate sporti) e pastaj të ngrejme ekupe dhe të pretendojmë për këto sporte.

Në rast se në Berat do të punojmë mbrapsht duke ngritur ekupe pa siguruar më parë këto qendra sportive, do të ndodhë si vite më parë që në kalendarët sportive kombëtare të Federatës Shqiptare të Basketbollit, programohej që "Tomori" nga që s'ka qendër sportive në Berat, ndeshjet t'i zhvillojë në Fier, Lushnje apo gjetkë?!

Kuptohet, s'ka përse të ngrihen këto ekupe përderisa nuk shërbejnë për argëtimin e sportdashësve të Beratit.

Lindita Malasi dhe Blerta Nallbani ishin 2 atlete të ekipit të femijëve dhe më vonë për të reja me trajnere Mjeshtrën e Merituar Marinda Preka.

Vajzat u aktivizuan në veprimtari të atletikës që kur ishin në kopshtet e qytetit dhe vite më vonë në garat e vrapimeve me shkollat 8-vjeçare të qytetit.

Lindita konkuronte në garat 100m, 200m dhe 400m dhe Blerta në 400m, 800m dhe 1500m.

Disa herë ato kanë zënë vende nderi.

Lindita: Ka zënë vende nderi në garat 200m, 400m në veprimtari kombëtare.

Në spartakiadën kombëtare të pionierëve është renditur në vendin e 2-të në 400m.


Në krosin kombëtar të të rejave zhvilluar në Berat ka zënë vendin e dytë. Lindita është fituese 2 herë e anketës tradicionale "10 sportiste të reja më të mira të "Tomorit".

Blerta: Është disa herë fituese e vrapimeve midis nxënësve të shkollave të qytetit.

Në kampionate të atletikës për të reja është shpallur nënkampione në garat 300m dhe 1500m. Është fituese e krosit kombëtar për të reja zhvilluar në Sarandë.

Blerina është fituese 3 herë e anketës "10 sportiste për të reja më të mira të "Tomorit".

Atëherë kur "Tomori" shkëlqeu




Në këtë vit shkëlqeu edhe tifozëria. Në stadium nuk u panë vende bosh dhe jashtë qytetit ekipin e ndiqnin tifozët, madje disa prej tyre shpenzonin për ekipin.

Sportdashësi Refat Çobo prindi i ish-presidentit të "Tomorit" (në foto djathtas)... Adrian Çobo, pas takimit në pallatin e kongreseve i dhuron presidentit të FIFA z. Blater bazorelievin e qytetit 2400-vjeçar të Beratit.

Në çastin e dorëzimit të dhuratës z. Refat thotë: "Ju falënderojmë familjarisht për ngushëllimin e djalit tonë që na bëre nëpërmjet telegramit, na ulë sadopak dhimbjen, ndaj familja iu ka bërë këtë dhuratë simbolike të qyteit, ku lindi dhe u rrit djali ynë, Adriani.


Ishte viti kur ekipi i futbollit "Tomori" shkëlqeu. Ai u ngjiti në një lartësi që nuk e kishte arritur në 75 vjet. Që aty "Tomori" i shikonte të 12 ekipet që i kishte nën vete. Lart kishte vetëm 1 ekip, kampionen "Tiranën".

Rezultati ishte meritë e futbollistëve, trajnerëve dhe e presidentit Adrian Çobo që në saj të përpjekjeve të mëdha që bëri afro në ekip futbollistë cilësorë duke u krijuar kushte të mrekullueshme.



Atëherë kur estrada e Beratit shkëlqente

Nokja



Nevrus Haznedari gjatë një shfaqje të estradës në fshat


Ndahet nga jeta Stavri Kuço

Në ekipin e të rinjve të futbollit "Tomori" në vitet 1950, 1953 me trajner Liko Kuçova, aktivizohej edhe djali nga lagjja "Vakëf" i qytetit të Beratit, Stavri Kuço.

Luante sulmues i krahut të djathtë. Ishte i shkathët dhe me forcë goditëse. Djali aktiv në shoqërinë sportive, i dashur, i thjeshtë e plot humor. Nuk bëri karrierë të gjatë si futbollist, por krejt ndryshe, ishte karriera si sportdashës i qytetit të vet.

Stavri punoi si drejtues në disa ndërmarrje tregtare shtetërore. Vitet e fundit gjendja shëndetësore nuk ka qenë e mirë.

Ditën e enjte Stavri ndahet nga jeta.



Kujdes Kovaçin!



Ishin fjalë që çdo trajner u linte porosi futbollistëve para ndeshjes me "Tomorin". Trajnerët për këtë ndeshje zgjidhnin mbrojtësin më të rehtë dhe e porositnin me një detyrë të vetme:

"Qepu Kovaçit! Nga ju dua vetëm që Kovaçi të mos shënojë!"


Por si thoni ju, e mbante kush Kovaçin?

1980, "Tomori" - "Besa"

1982, "Tomori" - "Tirana"



Karrige për Bar- Restorante



tel: 036220295

PREKNI TE ARDHMEN Drejtor Ilir Qepa

ADRESA:

AGJENSIA E AUTOBUZAVE
PERBALLE XHAMISE SE PLUMBIT.

FIRMA "DAED"

Ndërton në Berat, Durrës, Sarandë

BERAT: Pallat me 8 kate, apartament me sipërfaqe 160m² pranë xhamisë në Çelepias, okazion, çmime tepër të arsyeshme.

DURRËS: Pallat me 5 kate (shtëpi pushimi komode 1+1), te Shkëmbi i Kavajës, vija e parë buzë detit.

SARANDË: Pallat me 5 kate(1+1) pranë Disko "Mango"-s Komoditet, cilësi, çmime të arsyeshme

tel: 0692063390 - 0692063392